



MANUALI I LICENCIMIT TË NDËRMJETËSUESVE NË SIGURIME

PRISHTINË, TETOR 2017

Në përputhje me nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, dhe nenin 16 të Statutit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 tetor 2017 miratoi:

MANUALI I LICENCIMIT TË NDËRMJETËSUESVE NË SIGURIME

PËRMBAJTJA

1.	HYRJE.....	4
1.1.	Përkufizimet.....	6
2.	PROCESI I APLIKIMIT PËR LICENCIM	7
2.1.	Faza e para-aplikimit.....	7
2.2.	Faza e aplikimit.....	8
2.2.1.	Plani i biznesit	12
2.2.2.	Kapitali.....	14
2.2.3.	Struktura udhëheqëse.....	16
2.2.4.	Letrat mbështetëse.....	18
2.2.5.	Dorëzimi i aplikacionit.....	19
2.3.	Faza e pas-aplikimit.....	20
2.4.	Procesi i shqyrtimit.....	21
2.5.	Licencimi	22
2.5.1.	Licencimi i kompanive ndërmjetësuese.....	22
2.5.2.	Licencimi i degëve të kompanive të jashtme ndërmjetësuese.....	23
2.5.3.	Licencimi i ndërmjetësimit në sigurime si aktivitete shtesë.....	24
3.	MIRATIMET E TRANSAKSIONEVE TJERA.....	25
3.1.	Ndryshimi i emrit	26
3.2.	Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit.....	26
3.3.	Aksionarët kryesor	27
3.4.	Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë.....	28
3.5.	Hapja e degëve të reja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit.....	30
3.6.	Hapja e degëve ose subjekteve të varura jashtë vendit	30
3.7.	Auditori i jashtëm.....	31
3.8.	Bashkimet dhe përvetësimet.....	32
3.9.	Transaksionet që kërkojnë vetëm njoftim të BQK-së	34
4.	SHTOJCAT E APLIKACIONIT.....	35
5.	HYRJA NË FUQI.....	35

1. HYRJE

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka përgjegjësi për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e ndërmjetësuesve në sigurime në Republikën e Kosovës sipas nenit 23, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (më tutje: Ligji për BQK-në) dhe nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet (më tutje: Ligji për Sigurimet).

Korniza ligjore në fuqi, respektivisht Ligji për Sigurimet ndër tjerash përcakton se BQK-ja është kompetente për:

- licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- revokimin e licencave për ndërmjetësues;
- menaxhimin ose mbikëqyrjen e procedurës së rehabilitimit (administrimit zyrtar) dhe fillimin e procedurave të falimentimit;
- vlerësimin e kushteve dhe dhënien e miratimit/refuzimit për transaksionet e përcaktuara në kapitullin tre (3) të këtij manuali.

Sipas nenit 110 paragrafi 2 të Ligjit për Sigurimet, ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënies së asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi. Ndërmjetësuesit në sigurime ndahen në dy kategori, varësisht nga fakti nëse ata veprojnë kryesisht në llogari të siguruesve apo në llogari të të siguruarve. Kur ndërmjetësuesi vepron kryesisht në llogari të siguruesve, ata njihen si agentë, kurse kur ndërmjetësi vepron kryesisht në llogari të të siguruarve, ata njihen si broker dhe janë të pavarur nga siguruesit, produktet e të cilëve i ndërmjetëson.

Ndërmjetësuesit në sigurime ua sqarojnë klientëve kushtet e kontratave të sigurimeve dhe iu ndihmojnë në zgjedhjen e produkteve që siguruesit i ofrojnë, si dhe njëkohësisht iu ndihmojnë siguruesve në distribuimin e produkteve të tyre duke identifikuar nevojat e klientëve dhe përshtatur ato me kushtet e kontratave të sigurimit. Si rrjedhojë e natyrës specifike të kontratave të sigurimeve, kompleksitetit të tyre dhe dilemave të mundshme të klientëve për të hyrë në një marrëveshje sigurimi drejtpërdrejtë me një sigurues, ndërmjetësuesit në sigurime luajnë një rol të rëndësishëm në tregun e sigurimeve.

Aktiviteti i ndërmjetësimit në sigurime mund të kryhet nga agentët dhe brokerët të cilët mund të jenë të organizuar në forma të ndryshme ligjore si subjekte juridike, kompani vendore apo degë të kompanive të jashtme dhe si biznese individuale, për të ndërmjetësuar për aktivitetin e sigurimeve jetë apo jo-jetë. Për informata të hollësishme mbi secilën nga alternativat, të interesuarve për licencim si ndërmjetësues iu sugjerohet referimit shtojcës III – Alternativat e Licencimit për të vlerësuar cila nga alternativat është më e përshtatshme për vizionin e tyre.

Ndërmjetësimi në sigurime mund të kryhet edhe si aktivitet shtesë nga bankat e licencuara të operojnë në tregun e Republikës së Kosovës (nëse licencohen për aktivitetin shtesë të ndërmjetësimit në sigurime) si dhe nga agjencionet e udhëtimeve të cilat mund të licencohen për të ndërmjetësuar produktin e shëndetit në udhëtim.

Të interesuarit për të zhvilluar aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime duhet të aplikojnë për t'u licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Në kontekst të licencimit të ndërmjetësuesve në sigurime

objektivi i përgjithshëm i BQK-së është që të sigurojë një proces transparent gjithëpërfshirës, i cili ndihmon për të siguruar një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe konkurrues në industrinë e sigurimeve. Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, përmes rritjes së transparencës dhe inkurajimit të efikasitetit dhe konkurrencës, BQK ka rishikuar politikat, procedurat dhe praktikatat e licencimit të siguruesve dhe ndërmjetësuesve në sigurime në mënyrë që të sigurojë një kornizë dinamike, efikase dhe të strukturuar. Pjesë e këtij procesi ka qenë edhe miratimi i Manualit të Licencimit të Ndërmjetësuesve në Sigurime.

Manuali i licencimit të ndërmjetësuesve në sigurime përcakton kushtet dhe procedurat e nevojshme që duhen përmbushur nga subjektet aplikuese për marrjen e licencës për të ushtruar aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, me qëllim të hyrjes në treg të subjekteve ndërmjetësuese të shëndosha dhe të qëndrueshme që mbështeten nga aksionarë të përshtatshëm dhe që kanë qëndrueshmëri financiare (në rastet e kompanive ndërmjetësuese në sigurime). Manuali ofron udhëzime të veçanta për pranimin dhe vlerësimin e aplikacioneve dhe përcakton dokumentet minimale të nevojshme për aplikim për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime. Duhet të theksohet se manuali është vetëm një udhëzues procedural dhe nuk përfshin të gjithë faktorët, që mund të vlerësohen gjatë fazës së analizës. Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikacionit, informacione shtesë mund të kërkohen nga ana e BQK-së varësisht nga kompleksiteti i situatës. Megjithatë, manuali shërben si një udhëzues për të gjithë të interesuarit potencial për themelimin e kompanive të ndërmjetësimit në sigurime dhe njëkohësisht lehtëson trajtimin e aplikacioneve për licencim nga stafi i Departamentit për Licencim dhe Standardizim në kuadër të BQK-së nga i cili do të shfrytëzohet si manual referues, udhëzues pune dhe si mjet trajnues.

Struktura vijuese e manualit është si më poshtë.

Kapitulli i dytë (2) i manualit shtjellon pjesën thelbësore të procesit të aplikimit duke filluar nga faza e para-aplikimit, faza e aplikimit dhe faza e pas-aplikimit. Faza e para-aplikimit kalon nëpër çështjet bazike, duke përfshirë vendimin nëse themelimi i një ndërmjetësuesi në sigurime është gjëja e duhur për të interesuarit dhe çfarë mund të jenë alternativat. Të interesuarit për themelimin e një ndërmjetësuesi, mund të gjejnë këtë pjesë të dobishme sepse këtu përfshihen detajet e takimeve para aplikimit ku ndahen pritjet tona që mundëson kuptimin se çfarë do të thotë kjo për aplikuesin dhe burimet e tij, gjëra të cilat vlerësohen të dobishme për të dyja palët: të interesuarit dhe BQK-në.

Faza e aplikimit, fillon me listimin e dokumentacionit minimal të nevojshëm për aplikim dhe vazhdon me diskutimin e strukturuar përreth komponentëve kryesor të aplikacionit për licencim të aktivitetit për ndërmjetësim në sigurime për nga pesha a tyre në vendimmarrjen e BQK-së. Si përmbyllje e kësaj pjese të kapitullit është sqarimi i dorëzimit formal të aplikacionit në BQK.

Faza e pas-aplikimit përcakton se çka vlerëson BQK në aplikacionin për licencim të ndërmjetësuesve, sqaron arsyet për vendim pozitiv dhe ato për vendim negativ si dhe kohën që i duhet për të marrë një vendim për kërkesën për licencim. Faza e pas-aplikimit përfundon me fazën opcionale në këtë proces, vendimin për miratimin e licencimit apo refuzimin e licencimit, i cili merret pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjithë dokumenteve dhe informacioneve të pranuar si aplikacion në këtë proces. Gjatë kësaj faze, BQK mund të kryej edhe inspektim në vend në objektet e ndërmjetësuesve të propozuar për verifikimin e kushteve për fillimin e biznesit financiar.

Transaksionet tjera të cilat realizohen pas licencimit të ndërmjetësuesve për të cilat kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së, janë sqaruar në kapitullin tre (3) të këtij manuali. Në këtë kapitull është

përcaktuar gjithashtu edhe dokumentacioni i kërkuar për miratimin e këtyre transaksioneve, afatet si dhe procedura e shqyrtimit.

Manuali përmbillet me kapitullin e katër (4) i cili përmban listën e shtojcave të manualit të cilat japin sqarime të detajuara për çështje të caktuara duke mbështetur përmbajtjen e manualit dhe formularët e nevojshëm për aplikim për licencim të ndërmjetësuesve dhe miratim të transaksioneve tjera.

Për ndonjë sqarim shtesë apo për ndonjë pyetje individuale, të interesuarve ju rekomandohet të kontrollojnë pjesën “Pyetjet më të shpeshta” në uebfaqen e BQK-së si dhe shtojcat: I –Procesi i Licencimit. II – Kriteret e Licencimit dhe III – Alternativat e Licencimit dhe IV - Ndërmjetësuesit e jashtëm, të këtij manuali apo të kontaktojnë direkt Departamentin për Licencim dhe Standardizim në BQK përmes emailit Licencimi@bqk-kos.org ose përmes telefonit në numrin +381 (0) 38 222 055.

1.1. Përkufizimet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë manual kanë të njëjtin kuptim siç përcaktohen me nenin 3 të Ligjit për Sigurimet dhe nenin 2 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime si dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllim të këtij manuali:

Ndërmjetësim në sigurime- është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënies së asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi.

Ndërmjetësues në sigurime -është personi fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi, për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime.

Kompani ndërmjetësuese në sigurime - nënkupton kompaninë e agjentëve dhe kompaninë e brokerëve.

Agjenti i sigurimeve – është personi fizik, i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi sipas një kontrate ndërmjetësimi për të zhvilluar aktivitet ndërmjetësimi në sigurime në llogari të siguruesve. Përveç kësaj, agjent i sigurimeve konsiderohet edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e agjentëve, bankën ose agjencionin e udhëtimit të licencuar për aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, për të vepruar në llogari të siguruesve.

Kompani e agjentëve - është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga një ose me shumë sigurues, që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime, në llogari të siguruesit.

Broker i sigurimeve – është personi fizik, i licencuar nga BQK-ja që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguarve. Brokeri ndërmjetëson në mes të të siguarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale. Përveç kësaj, broker i sigurimeve konsiderohen edhe personi fizik që është në marrëdhënie të rregullt pune me kompaninë e brokerimit ose bankën e licencuar për aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime.

Kompani e brokerimit - është person juridik i licencuar nga BQK-ja që të zhvillojë aktivitet të ndërmjetësimit në sigurime dhe që vepron në llogari të të siguarve. Kompania e brokerimit ndërmjetëson në mes të të siguarve dhe një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale.

Menaxher i lartë- nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zëvendëskryeshefin ekzekutiv dhe zyrtarin kryesor financiar të kompanisë ndërmjetësuese në sigurime.

Drejtor- nënkupton anëtarin e bordit të drejtorëve të kompanisë ndërmjetësuese në sigurime.

2. PROCESI I APLIKIMIT PËR LICENCIM

Ky kapitull fillon me zbërthimin e fazës së para-aplikimit si fazë fillestare e procesit të licencimit të ndërmjetësuesve në sigurimeve si dhe sqarohet takimi informues para aplikimit¹, si pjesa më e rëndësishme e kësaj faze. Kapitulli pastaj vazhdon me shtjellimin e fazës së aplikimit e cila fillon me marrjen e vendimit përfundimtar për të aplikuar për licencim si ndërmjetësues. Kjo pjesë përfshin informacion në lidhje me atë se çka duhet të përmbaj aplikacioni për licencim si ndërmjetësues. Faza e aplikimit pasohet nga ajo e pas-aplikimit ku sqarohet se çka vlerëson BQK dhe sa kohë mund t'i duhen BQK-së për të marr një vendim. Kapitulli përfundon me sqarimin e fazës opcionale në këtë proces, që ka të bëjë me vendimin për licencim apo refuzim të licencimit, i cili merret pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjithë dokumenteve dhe informacioneve të pranuar si aplikacion në këtë proces.

2.1. Faza e para-aplikimit

Të interesuarit për licencim si ndërmjetësues në sigurime, fillimisht duhet të vlerësojnë në varësi të planit të biznesit ose aktiviteteve që dëshirojnë t'i ndërmarrin, nëse themelimi i një ndërmjetësuesi është opsioni i vetëm apo opsioni më i përshtatshëm për ta. Të interesuarit duhet të shqyrtojnë të gjitha alternativat e licencimit për aktivitet të ndërmjetësimit të cilat përkojnë me shkallë të ndryshme të kufizimeve ligjore të vendosura në fushëveprimin ose madhësinë e secilës prej këtyre alternativave të aktiviteteve ndërmjetësuese. Duhet të mbahet parasysh se këto aktivitete përputhen me nivele të ndryshme të rregullimit nga ana e BQK-së sipas procedurave ligjore në fuqi. Për informata të hollësishme mbi secilën nga alternativat, të interesuarve për licencim si ndërmjetësues iu sugjerohet referimit shtojcës III – Alternativat e Licencimit për të vlerësuar cila nga alternativat është më e përshtatshme për vizionin e tyre.

Nëse pas shqyrtimit të alternativave të parashtruara, të interesuarit konstatojnë se licencimi si ndërmjetësues është rruga e duhur dhe janë të gatshëm për të filluar procesin, duhet të kontaktojnë BQK-në. Të interesuarit për të themeluar një kompani të ndërmjetësimit apo degë të një kompanie të jashtme të ndërmjetësimit duhet të kërkojnë nga BQK organizimin e takimit informues para aplikimit. Kërkesa për takim dërgohet nga përfaqësuesi i autorizuar i aplikuesit në e-mailin kontaktues të Departamentit për Licencim dhe Standardizim: Licencimi@bqk-kos.org. BQK-ja pranon aplikacionet për një kompani ndërmjetësuese apo degë të jashtme të ndërmjetësuesit vetëm nëse paraprakisht është mbajtur takimi informues.

Takimi informues nuk është i obligueshëm për ndërmjetësuesit individual por me kërkesë të palës së interesuar BQK-ja mund të vendos organizimin e takimit informues edhe për ndërmjetësuesit individual.

Vlen të theksohet se pjesa dërrmuese e manualit fokusohet në informacione të cilat vlejné për kompani të ndërmjetësimit apo degë të kompanive të jashtme të ndërmjetësimit të cilat aplikohen përshtatshmërisht për ndërmjetësues individual.

Takimi Informues

Para zhvillimit të takimit informues me BQK-në, të interesuarit duhet ta shqyrtojnë plotësisht këtë manual, në mënyrë që të njoftohen me të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me licencimin e ndërmjetësuesve dhe

formave ligjore të tyre.

Takimi informues është i obligueshëm për licencimin e kompanive ndërmjetësuese sepse mundëson:

- kuptimin e procesit të licencimit dhe çfarë ndodh në faza të ndryshme;
- kuptimin e pritjeve të BQK-së;
- identifikimin e ndonjë shqetësimi të veçantë që BQK mund të ketë në fillim që mund të ndihmoj në vendimin nëse të interesuarit duan të shpenzojnë kohë dhe para në një aplikacion që nuk mund të përparojë më tej;
- dorëzimin sa më të plotë të aplikacionit.

Para mbajtjes së takimit informues të interesuarit për aplikim duhet të prezantojnë një përmbledhje të shkurtër të propozimit të biznesit, që si minimum duhet të përmbajë:

- arsyeshmërinë e themelimit të ndërmjetësuesit në sigurime si dhe strategjinë fillestare të biznesit duke specifikuar se cilat shërbime do të ofrohen, si do të ofrohen ato dhe tregun e synuar;
- burimet e financimit - si do të financohen dhe nëse kanë ndonjë investitor dhe/ose fonde në vend;
- pronësinë dhe ekipin menaxherial - detajet e pronarëve dhe menaxherëve të propozuar, për aq sa ato njihen;
- planin kohor- një pasqyrë dhe afat kohor të planit për të themeluar dhe zhvilluar aktivitetin e ndërmjetësimit në sigurime.

Takimi informues udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit për Licencim dhe Standardizim dhe Udhëheqësi i Divizionit për Licencim apo ndonjë i deleguar i tij, si dhe një zyrtar i lartë përgjegjës për aktivitetet e licencimit. Rrjedhimisht, në takim duhet të përfaqësohen personalisht ose përmes përfaqësuesve të autorizuar të gjithë aksionarët kryesorë të kompanisë së re të ndërmjetësimit të propozuar. Gjatë takimit, të interesuarit për aplikim inkurajohen që të shtrojnë pyetje rreth procesit të licencimit dhe paqartësive të mundshme që kanë, në mënyrë që të sigurohet përgatitja e aplikacionit në mënyrë sa më efektive. Departamenti për Licencim dhe Standardizim duhet të mbajë procesverbalin e takimeve informuese dhe si dëshmi të këtij procesi ta vendosë në dosjen e aplikuesit.

Takimi informues iu mundëson të interesuarve për aplikim për të diskutuar planet me BQK-në dhe i jep mundësi BQK-së për t'i kuptuar ato plane. Rrjedhimisht, në fund të takimit pritët që të interesuarit të kenë më të qartë procesin e licencimit për ndërmjetësues dhe se aplikacioni kur të dorëzohet, të jetë me cilësi të mjaftueshme për BQK-në që të marrë një vendim sa më shpejt që të jetë e mundur. Ritmi në të cilin të interesuarit për aplikim përparojnë përmes fazës së para-aplikimit varet në masë të madhe nga vet ata dhe përgatitjet e tyre.

2.2. Faza e aplikimit

Aplikimi fillon me listimin e dokumenteve mbështetëse që duhet të jenë pjesë e aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesve. Pjesa tjetër është e strukturuar rreth komponentëve kryesor të aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime për nga pesha a tyre në vendimmarrjen e BQK-së, të cilat janë plani i biznesit, struktura udhëheqëse, financimi, dhe letra e mbështetjes në rastet kur aplikohet për themelimin e një dege

të kompanisë ndërmjetësuese të jashtme, nëse është e aplikueshme. Si përmbyllje e kësaj faze është sqarimi i dorëzimit formal të aplikacionit në BQK.

Varësisht nga lloji dhe forma ligjore e ndërmjetësuesit në fazën e aplikimit, të sqaruara më detajisht në shtojcën III Alternativat e Licencimit, aplikuesit duhet të plotësojnë dokumente të cilat kërkohen me Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Të gjithë aplikuesit për licencim si ndërmjetësues në sigurime duhet të plotësojnë formularët zyrtar të BQK-së për aplikim (shtojca 2 e këtij manuali) dhe duhet të paguajnë tarifën zyrtare për aplikim sipas tarifave zyrtare të BQK-së.

Aplikimi për licencim si ndërmjetësues individual

Sipas neneve 4 dhe 6 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, aplikacioni për licencim të ndërmjetësuesve individual duhet të shoqërohet nga informacionet e mëposhtme:

- emri, nacionaliteti, vendbanimi, kualifikimet, përvoja dhe referencat përcjellëse, për licencim si agjent dhe broker. Për t'u licencuar si Broker nevojitet që të dëshmohet përvoja një (1) vjeçare në sigurime apo së paku dy (2) vjeçare në fushën e shërbimeve financiare;
- diploma e noterizuar si dëshmi për kualifikimin shkollor të mesëm të kërkuar për agjent, ndërsa për broker individual diploma e noterizuar si dëshmi për kualifikim universitar arsimor të kërkuar;
- dëshmi për përfundimin me sukses të provimit profesional për agjent respektivisht broker nga Shoqata e Sigurimeve të Kosovës;
- dëshmi zyrtar nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar për agjent;
- certifikata e regjistrimit të biznesit individual nga Agjencioni për Regjistrimin e Biznesit, për agjentët dhe brokerët (në rastet kur brokeri do të zhvilloj aktivitetin ndërmjetësues si i punësuar i një kompanie të brokerimit, nuk kërkohet certifikata e regjistrimit të biznesit);
- vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës me të cilin dëshmojnë se nuk kanë tatime të papaguara agjentët dhe brokerët;
- dëshmi për sigurim nga përgjegjësia profesionale për agjentët dhe brokerët të regjistruar si biznese individuale;
- dokument (Marrëveshja e qirasë dhe Njoftimi - forma për plotësimin e kushteve teknike) që vërteton se ndërmjetësuesi (agjenti dhe brokeri individual) disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit;
- para-kontrata e lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilit do të zhvilloj aktivitetin agjenti; formulari zyrtar i BQK-së përmes të cilit autorizojnë BQK-në që të kërkoj informacione nga institucionet kompetente me qëllim të verifikimit të të kaluarës së tyre penale për agjent dhe broker;

Brokeri në sigurime duhet të mos jetë i punësuar në ndonjë sigurues, gjithashtu të mos ketë qenë kryeshëf ekzekutiv apo anëtar i bordit të ndonjë siguruesi, gjatë gjashtë muajve të fundit nga momenti i aplikimit.

Aplikimi për licencim si kompani ndërmjetësuese

Sipas neneve 5 dhe 7 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, aplikacioni për licencim të kompanive ndërmjetësuese duhet të shoqërohet nga informacionet e mëposhtme:

- dokumentet përbërëse të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, duke përfshirë kopje të noterizuar të dokumentacionit origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar;
- emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet, përvoja dhe referencat përcjellëse si dhe kopja e dokumentit identifikues të drejtorëve (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherëve të lartë të kompanisë së propozuar, si dhe të së paku një agjenti respektivisht brokeri të licencuar nga BQK-ja;
- dëshmi zyrtar nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale për aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxheret e lartë të propozuar;
- formulari zyrtar i BQK-së përmes të cilit autorizojnë BQK-në që të kërkoj informacione nga institucionet kompetente me qëllim të verifikimit të të kaluarës së tyre penale për çdo drejtor (kur është e aplikueshme) dhe menaxher të lartë të kompanisë së propozuar;
- dokument që dëshmon shumën e kapitalit të zotuar të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, duke përfshirë të dhëna për burimin e atij kapitali;
- plani i biznesit që përfshinë, ndër të tjera, strukturën organizative të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite, dhe nëse ekzistojnë pasqyrat financiare të audituara të aksionareve për tri (3) vitet e fundit;
- para-kontrata me siguruesin në llogari të së cilit do të zhvilloj aktivitetin- për kompanitë e agjentëve;
- dokument (Marrëveshja e qirasë dhe Njoftimi-forma për plotësimin e kushteve teknike) që vërteton se kompania ndërmjetësuese disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë;
- në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës, është një institucion financiar i jashtëm që propozon themelimin e një kompanie ndërmjetësuese varëse në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të aktiviteteve të propozuara në Kosovë, (nëse kërkohet me legjislacionin e vendit amë) si dhe miratimi zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së ndërmjetësimit. Në dokumentet e aplikuesve të jashtëm duhet të sjellët dhe statuti i kompanisë së jashtme amë së bashku me raportet financiare të kompanisë amë.

Aplikimi për licencim si degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese

Sipas nenit 8 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, aplikacioni për licencimin e degës së kompanisë të jashtme ndërmjetësuese, duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- konfirmimi me shkrim që vërteton se kompania ndërmjetësuese e jashtme është e licencuar si kompani ndërmjetësuese, në vendin e origjinës;
- statuti i kompanisë së jashtme ose ekuivalenti i tij;
- raportet financiare të kompanisë së jashtme të agjentëve ose brokerimit, për tri (3) vitet e fundit;

- miratimi zyrtar me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit të origjinës për hapjen e degës në Kosovë, nëse sipas legjislacionit të vendit të origjinës kërkohet një gjë e tillë;
- miratimi zyrtar me shkrim nga organet përgjegjëse të kompanisë së jashtme ndërmjetësuese për hapjen e degës në Kosovë;
- letër sigurie e adresuar për BQK-në, nga kompania e jashtme ndërmjetësuese, me anë të së cilës pranon detyrimin ligjor për pagesën e të gjitha obligimeve të degës së saj në Kosovë
- certifikata e regjistrimit të bizneseve në Republikën e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (si degë e kompanisë së jashtme ndërmjetësuese);
- dëshmi zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale për aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxheret e lartë të propozuar;
- plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë;
- dokumentacion se ka të punësuar me kohë të plotë, së paku një agjent ose broker të licencuar;
- dokument që dëshmon shumën e kapitalit (si fond garantues) të zotuar të degës së propozuar të kompanisë së jashtme ndërmjetësuese, duke përfshirë të dhëna për burimin atij kapitali;
- polica e sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
- dokument (Marrëveshja e qirasë dhe Njoftimi - forma për plotësimin e kushteve teknike) që vërteton se kompania ndërmjetësuese disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë;
- para-kontrata e lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilës do të veprojnë- në rastin e degës së kompanisë së jashtme të agjentëve.

Aplikimi për licencim të ndërmjetësimit si aktivitet shtesë nga bankat

Sipas nenit 10 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, aplikacioni për licencim për ushtrimin e ndërmjetësimit në sigurime si aktivitet shtesë të bankave të cilat janë të licencuara të operojnë në Kosovë, duhet të shoqërohet nga informacionet e mëposhtme:

- certifikata e regjistrimit të biznesit (shtimi i aktivitetit në regjistrin biznesit);
- vendimi i organit përgjegjës të bankës për angazhimin në veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;
- emri, nacionaliteti, vendbanimi, kualifikimi, përvoja dhe referencat përcjellëse, kopja e dokumentit identifikues si dhe kopje e licencës të së paku një agjenti respektivisht brokeri të licencuar nga BQK-ja;
- plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- të dhëna për strukturën që do të kryej veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime;

- para-kontrata e lidhur me siguruesit në emër dhe në llogari të cilëve do të veprojë, në rastin kur banka kërkon të licencohet si agjent i sigurimeve;
- policën e sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
- dokument (Marrëveshja e qirasë dhe Njoftimi-forma për plotësimin e kushteve teknike) që vërteton se banka disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë.

Aplikimi për licencim të ndërmjetësisimit si aktivitet shtesë nga agjencionet e udhëtimit

Sipas nenit 11 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, aplikacioni për licencim për ushtrimin e ndërmjetësisimit në sigurime si aktivitet shtesë nga agjencionet e udhëtimit, për produktin e sigurimit të shëndetit në udhëtim, duhet të shoqërohet nga informacionet e mëposhtme:

- certifikata e regjistrimit të biznesit (shtimi i aktivitetit në regjistrin e biznesit);
- plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësisimit, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- dokumenti që vërteton se agjenti përmes të cilit do të ushtrohet aktiviteti i sigurimit është i licencuar nga BQK-ja si dhe kontrata e punës me kohë të plotë me agjencionin e udhëtimit;
- dokument që vërteton disponimin e ambienteve dhe infrastrukturës të nevojshme për shitjen e sigurimit të shëndetit në udhëtim;
- para-kontrata e lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilit do të veprojë;
- policën e sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

2.2.1. Plani i biznesit

Plani i biznesit është një prej elementeve kyçe në procesin vendimmarrës për dhënien e licencës për një kompani ndërmjetësuese në sigurime.

Plani i biznesit i kompanisë ndërmjetësuese të propozuar duhet të jetë i konstruktuar në formë të tillë, që të zbërthej qartë zhvillimin strategjik afatgjatë të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar në tregun e synuar duke pasur parasysh qëndrueshmërinë financiare të saj. Strategjia afatgjatë e kompanisë ndërmjetësuese së propozuar duhet të përkthehet në qëllime specifike dhe objektiva të matshme afatmesme dhe afatshkurtra, të cilat duhet të arsyetojnë rritjen e parashikuar si dhe të mbështetet me kapitalin e kompanisë ndërmjetësuese të propozuar duke arsyetuar kështu projeksionet financiare.

Plani i biznesit duhet minimalisht të përmbajë informatat e mëposhtme:

- pasqyrën e biznesit: strategjinë e përgjithshme të ndërmjetësuese të propozuar dhe detajet mbi aktivitetin e planifikuar ndërmjetësues;
- analizën e tregut duke përfshirë analizën e konkurrencës direkte dhe indirekte;
- analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së aseteve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tri (3) vitet e para të operimit;

- produktet e sigurimit që planifikohet të ndërmjetësohen;
- strukturën udhëheqëse të kompanisë ndërmjetësuese.

Pasqyra e biznesit

Plani i biznesit duhet të përmbajë deklaratën e filozofisë së përgjithshme të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar dhe të përcaktojë vizionin e saj për qëndrueshmërinë financiare dhe ardhmërinë e ndërmjetësuesit. Në këtë pjesë duhet të shpaloset strategjia e përgjithshme e kompanisë ndërmjetësuese të propozuar e zbërthyer në qëllime afatshkurtra dhe afatmesme të cilat duhet të jenë specifike, të qarta dhe të matshme. Në këtë pjesë pritet edhe argumentimi mbi vlerën e shtuar të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar për sistemin financiar në vend.

Në këtë pjesë të planit duhet edhe të bëhet shpalosja e aktivitetit të planifikuar ndërmjetësues, konkretisht detajet e produkteve dhe shërbimeve të cilat planifikohen të ofrohen si dhe objektivat për të ardhmen lidhur me këto produkte dhe shërbime. Aktiviteti duhet të përfshijë gjithashtu edhe trendin e rritjes së ndërmjetësimit të kontratave siguruese, të hyrave nga komisionet sipas klasave të sigurimeve dhe aktivitetet tjera ndërmjetësuese të parapara.

Analiza e tregut

Në planin e biznesit, kompania ndërmjetësuese e propozuar duhet të paraqes analizën e tregut ku duhet të përshkruhet industria e sigurimeve në të cilën synon të zhvillojë aktivitet ndërmjetësues, me detaje të mjaftueshme për të mundësuar vlerësimin dhe identifikimin e sfidave dhe perspektivës me të cilat kompania ndërmjetësuese e propozuar do të përballë. Në këtë pjesë duhet të identifikohet qartë dhe të përshkruhet mjaftueshëm tregu i synuar në të cilin pritet të ofrohen aktivitetet e përshkruara në pjesën parapra. Gjithashtu, në analizën e tregut duhet të identifikohen nevojat e tregut për produktet dhe shërbimet e propozuara si dhe argumentohet plotësimi i këtyre nevojave përmes aktivitetit ndërmjetësues që planifikohet të ofrohet. Deri në masën e nevojshme për marrjen e vendimeve afariste, duhet të përshkruhen edhe trendet e zhvillimit të tregut të synuar.

Komponent i rëndësishëm i analizës së tregut është analiza e konkurrencës. Kompania ndërmjetësuese e propozuar në planin e biznesit duhet identifikojë qartë konkurrencën direkte dhe indirekte brenda tregut të synuar dhe atë që mund të ndikojnë në strategjinë zhvillimore të saj. Në analizën e konkurrencës duhet të paraqitet edhe pozicioni i kompanisë ndërmjetësuese të propozuar përballë konkurrencës së identifikuar.

Analiza e tregut duhet të përmbajë edhe identifikimin e qartë të kërkesave rregullative që aplikohen në tregun e synuar si dhe strategjinë që kompania ndërmjetësuese e propozuar do ta ndjekë për të siguruar pajtueshmëri me to. Pjesë përbërëse e analizës së tregut duhet të jetë edhe analiza e konkurrueshmërisë apo *SWOT Analiza* ku identifikohen përparësitë dhe dobësitë e kompanisë ndërmjetësuese të propozuar kundruall konkurrencës, kërkesave rregullative dhe tregut në përgjithësi.

Analiza e tregut duhet të bazohet në përdorimin e të dhënave aktuale ekonomike në dispozicion, në mënyrë që të gjitha planifikimet të pasqyrojnë apo të jenë sa më të përafërta me realitetin. Burimet e informacionit të përdorura rishqyrtohen për besueshmërinë e tyre dhe janë të rëndësishme në rishikimin e të dhënave.

Struktura organizative

Në planin e biznesit duhet të shpjegohet e gjithë struktura organizative e kompanisë ndërmjetësuese të propozuar me detaje të mjaftueshme të cilat do të mundësojnë vlerësimin e adekuatshëm të asaj strukture

konform kërkesave ligjore dhe rregullative për zhvillimin e aktivitetit ndërmjetësues. Për të lehtësuar procesin e vlerësimit të BQK-së në këtë pjesë duhet të paraqitet edhe një organogram i cili duhet të përmbajë minimalisht informatat e mëposhtme:

- skemën organizative me emrat individual, sipas nevojës;
- përbërjen e bordit të drejtorëve dhe përgjegjësitë e tij (nëse është e aplikueshme);
- përshkrimin e pozitës së kryeshefit ekzekutiv dhe menaxherëve tjerë të lartë duke përfshirë kufijtë mesatarë të pagave (përfshirja e bonuseve ose pagesave tjera jomonetare p.sh. automobilat, banimi);
- planifikimin e personelit (numri i punëtorëve/departamentet).

Në kuadër të strukturës organizative kompania ndërmjetësuese e propozuar duhet të kujdeset të organizojë skemën udhëheqëse sikurse përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe shpalos planet rreth krijimit të funksioneve kyçe ndërmjetësuese të kërkuara me kornizën ligjore në fuqi.

Analiza Financiare

Plani i biznesit të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar duhet të përmbaj edhe analizën financiare ku përfshihet shpalosja e strukturës së aseteve, detyrimeve dhe kapitalit si dhe projeksionet financiare për tri (3) vitet e para të operimit.

Në kuadër të strukturës së aseteve dhe detyrimeve, kompania ndërmjetësuese e propozuar duhet të paraqes përparësitë dhe mangësitë e strukturës së propozuar, duke përfshirë çdo veprim që do të ndërmerret për të zvogëluar rreziqet si dhe teknikat dhe sistemet për menaxhimin e tyre. Për strukturën e kapitalit kompania ndërmjetësuese e propozuar në planin e biznesit të saj duhet të sqaroj mënyrën apo bazën e përdorur për të arritur strukturën e kapitalit të propozuar dhe të argumentoj se përse shumica e propozuar është e mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit të planifikuar ndërmjetësues. BQK pret që kompania ndërmjetësuese e propozuar të posedojë një shumë të mjaftueshme të kapitalit për të konkurruar në mënyrë efektive në treg dhe të mbështes në mënyrë adekuate operationet e planifikuara. Duke marr parasysh që është element kyç në procesin vendimmarrës për dhënien e licencës kjo pjesë elaborohet më tutje në pikën 2.2.2. në këtë kapitull.

Parashikimet apo projeksionet financiare në planin e biznesit të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar duhet të tregojnë trendet e ardhshme të aseteve, detyrimeve dhe kapitalit, aftësisë paguese- solvencës, vëllimin për çdo lloj shërbimi, investimet fikse të mjeteve si dhe shpërblimin e menaxhmentit dhe stafit. Parashikimet duhet të bëhen në bazë të planeve dhe objektivave të planifikuara (të cilat duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit), analizave të tregut dhe strategjive të diskutuara më lart. Forma e këtyre parashikimeve të kërkuara është e paraqitur në Shtojcën D – Forma e Projeksioneve Financiare, në këtë manual.

Pika 2.2.2. e këtij kapitulli aplikohet edhe për degët e kompanive të jashtme ndërmjetësuese.

2.2.2. Kapitali

Për të ushtruar veprimtari ndërmjetësuese në Republikën e Kosovës një kompani ndërmjetësuese apo dega e një ndërmjetësuesi të jashtëm, varësisht nëse aplikon si kompani e agjentëve apo kompani e brokerimit duhet të zotojnë kapital fillestar minimal në shumë prej pesë mijë (5,000) Euro nëse themelohet si kompani të agjentëve dhe dhjetë mijë (10,000) Euro nëse themelohet si kompani të brokerimit. Në rastet e degëve të

kompanive të jashtme ndërmjetësuese duhet të zotojnë kapital në vlerë prej pesë mijë (5,000) Euro respektivisht dhjetë mijë (10,000) Euro si Fond Garantues, i cili do të mirëmbahet në çdo kohë.

Kapitali i kompanisë ndërmjetësuese të propozuar duhet të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat rregullative, si dhe të sigurojë një mbrojtje për ndërmjetësuesin e propozuar sidomos gjatë organizimit fillestar dhe fazave fillestare të operimit. BQK-ja ka të drejtë për të kërkuar rritjen e minimumit të kapitalit për kompaninë ndërmjetësuese të propozuar, bazuar në aplikacionin e saj, konkretisht planin e biznesit dhe projektionet financiare. Përveç kapitalit të zotuar, kompania ndërmjetësuese e propozuar në dokumentacionin e saj duhet të paraqet edhe planet për rritjen e tij brenda tre viteve të para. Gjithashtu duhet shpjeguar se si planifikon se do të mbajë kompaninë në pajtueshmëri me rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe rregulloret tjera që ndikojnë në kapital.

Kompania ndërmjetësuese e propozuar në planin e biznesit duhet të përshkruaj edhe strukturën e kapitalit, ku duhet paraqitur vlera nominale për aksion dhe çmimi i shitjes për aksion. Për aksionarët që posedojnë më shumë se pesë përqind (5%) të aksioneve të ndërmjetësuesit, duhet të sigurohen të dhënat financiare (referojuni shtojcës B dhe C në këtë manual). Të dhënat financiare do të përfshijnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave (fitimin/humbjen) gjatë tri (3) viteve të kaluara (nëse janë të aplikueshme). BQK-ja do të vlerësojë aksionarët e propozuar me mbi dhjetë përqind (10%) të aksioneve për të përcaktuar aftësinë aktuale financiare të tyre apo interesave të tyre të ndërlidhura, që do të mund të ndikonin negativisht në kompaninë ndërmjetësuese të propozuar.

Si pjesë e aplikacionit, aplikuesit duhet t'i sigurojnë BQK-së detajet e plota mbi burimet e kapitalit. Informatat e dhëna në BQK duhet të nënshkruhen nga aksionarët me dëshminë për saktësinë dhe kompletimin e tyre. BQK-ja do të verifikoj burimet dhe do të kërkojë që shuma e kapitalit të paguhet para lëshimit të licencës.

Përshtatshmëria e aksionarëve

Përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë potencial është gjithashtu element shumë i rëndësishëm në vlerësimin e BQK-së. Çdo aksionar kryesor potencial duhet të jetë në gjendje të demonstrojë qëndrueshmëri financiare. Kjo përfshin dëshmi të përmbushjes së shpejtë të detyrimeve financiare të kaluara dhe një gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare. Aksionari kryesor potencial duhet të dorëzojë dokumentacionin valid, që vërteton pagesën e të gjitha detyrimeve fiskale me kohë. Dokumenti i tillë duhet të jetë i lëshuar jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e aplikimit.

Gjatë shqyrtimit të aplikacionit, BQK-ja do të verifikojë në mënyrë të pavarur, personat që kontrollojnë kompaninë ndërmjetësuese ose që janë propozuar të kontrollojnë atë. Ky autorizim përfshin mbledhjen e dëshmive dhe dokumenteve në procedurat formale sipas procedurave administrative përkatëse.

BQK-ja do të vlerësojë, strukturën e pronësisë së një kompanie ndërmjetësuese të propozuar si tërësi, si dhe përshtatshmërisë individuale të aksionarëve, në mënyrë që të sigurojë se struktura e pronësisë nuk do të pengojë mbikëqyrjen efektive të saj. Kërkesat e cekura më lartë janë kërkesa të vazhdueshme për aksionarët ekzistues dhe aksionarët e ri potencial. Për këtë qëllim BQK ka të drejtë të mbledhë dëshmi në pajtim me nenet 10, 24 dhe 35 të Ligjit për Sigurimet. Për më tepër rreth dokumentacionit dhe detajeve tjera referohuni në Shtojcat B dhe C të këtij manuali.

2.2.3. Struktura udhëheqëse

Bordi i Drejtorëve nëse (është e aplikueshme) dhe menaxhmenti i lartë është shumë i rëndësishëm për suksesin e një kompanie ndërmjetësuese të re. Përzgjedhja e një kryeshefi ekzekutiv dhe menaxhmenti të lartë të kualifikuar dhe profesional, si dhe një bordi të drejtorëve adekuat (nëse është e aplikueshme) është një ndër detyrat më me rëndësi të ndërmjetësuesit të propozuar. Kryeshefi ekzekutiv i propozuar duhet të përfshihet në mënyrë aktive në zhvillimin dhe kompletimin e aplikacionit për licencë dhe duhet të jetë plotësisht i njoftuar me planin e biznesit të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar pasi që ai person duhet të zbatojë drejtpërdrejtë atë plan.

Përshtatshmëria e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të propozuar konsiderohet si thelbësore në procesin e BQK-së për licencimin dhe mbikëqyrjen e kompanive ndërmjetësuese. Si pjesë e procesit të licencimit, Rregullorja për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime ka përcaktuar se aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit.

BQK-ja mund kryej hulumtime lidhur me historikun e personave të propozuar si menaxher të lartë, drejtor dhe aksionar kryesor të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar si dhe menaxher të degëve të ndërmjetësuesve të jashtëm. Këto hulumtime mund të kryhen për të verifikuar nëse personat e propozuar i plotësojnë kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi për të qenë në ato pozita. BQK-ja mund të ndajë me rregullatorët e institucioneve të tjera financiare çfarëdo informacioni që e pranon si rezultat i hetimeve të saja.

Personi në vijim nuk mund të jenë kryesues dhe anëtar i bordit të drejtorëve të një ndërmjetësuesi:

- është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
- është larguar nga posti i një siguruesi ose ndërmjetësuesi me kërkesë të BQK-së;
- me vendim të organeve kompetente i është hequr ose pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit

Aplikuesit për licencim të kompanisë ndërmjetësuese duhet të dorëzojnë informatat e mëposhtme për drejtorët dhe menaxherët e lartë të ndërmjetësuesit:

- vendimin e organit kompetent për këto emërime;
- raportin individual (CV sipas shtojcës A të këtij manuali) për personin e emëruar;
- kopjen e legalizuar/noterizuar të përgatitjes shkollore, për drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të kompanisë ndërmjetësuese;
- dëshminë zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar;
- pëlqimin/autorizimin për verifikim të së kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
- informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

Informatat që duhet të jepen në Formularin e Aplikacionit për secilin individ të propozuar si drejtor ose menaxher të lartë përfshijnë:

- titullin apo pozitën e veçantë të propozuar në kompaninë ndërmjetësuese;
- emri nacionalitetin dhe vendbanimin;
- individët e ndërlidhur, kompanitë e ndërlidhura dhe partnerët e biznesit (vetëm për ata që aplikojnë si aksionarë aktual apo të mundshëm);
- edukimin;
- përvojën profesionale, përfshirë informatat aktuale të punësimit dhe informatat e punësimit të mëparshëm;
- referencat profesionale;
- aplikacionet e mëhershme;
- pjesëmarrja në situatat problematike financiare;
- veprat penale dhe masat disiplinore;
- deklaratat financiare/vlera neto.

Personi i propozuar duhet të nënshkruajë se informatat e lartpërmendura janë të vërteta dhe të sakta sipas njohurive të tij. Nëse ndonjë ndryshim material në aplikacion ndodh para vendimit të aplikacionit për licencë, individi duhet ta informojë BQK-në brenda pesë ditëve prej ndryshimit të ndodhur. Nëse personeli i nevojshëm nuk është përcaktuar atëherë aplikuesit duhet ta ofrojnë një plan për llojin (profilin) e kandidatëve d.m.th që përfshinë përvojën, edukimin për ata që do të punësohen në këto pozita.

Përveç asaj që u tha më lartë, anëtarët e bordit të drejtorëve i nënshtrohen edhe kërkesave të mëposhtme:

- bordi i drejtorëve (nëse është e aplikueshme) duhet ta këtë përbërjen sikurse përcaktohet me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në fuqi dhe statutin e kompanisë ndërmjetësuese;
- bordi i drejtorëve (nëse është e aplikueshme) zgjidhet nga aksionarët e kompanisë ndërmjetësuese dhe është përgjegjës për krijimin e politikave të tij, duke përfshirë politikat për menaxhim të riskut dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

BQK-ja përdorë kriteret e mëposhtme për të bërë vlerësimin para se të japë miratimin e saj për çdo individ të propozuar si drejtor apo menaxher i lartë:

- nuk është larguar nga ndonjë post menaxherial nga BQK-ja;
- nuk është dënuar nga një gjykatë penale për veprë penale për të cilën personi është ose ka mundur të dënohet me burgim prej gjashtë (6) muajsh a më shumë;
- nuk ka qenë debitor në një procedurë falimentimi ose paaftësie paguese brenda dhjetë (10) viteve të fundit;
- nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit për shkak të sjelljes së pahijshme personale;

- nuk ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i ndonjë institucioni financiar të cilit i është revokuar licenca apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruari tjetër jo vullnetar i së cilës është iniciuar gjatë mandatit të atij drejtori ose menaxheri të lartë.²
- historia personale e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të mundshëm duhet të dëshmojë se ata janë plotësisht të pavarur dhe se posedojnë kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për t'i kryer detyrat e tyre;
- drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë kualifikimet e duhura formale dhe aftësi personale që i japin mundësi atyre, që në mënyre kritike dhe adekuate të vlerësojnë politikatat e rëndësishme dhe çështjet strategjike, me të cilat do të ballafaqohet kompania ndërmjetësuese dhe të artikulojnë qartë pikëpamjet e tyre mbi çështjet e tilla;
- drejtorët dhe menaxherët e lartë, duhet të kenë të përfunduar shkollimin, se paku në nivel universitar dhe duhet të kenë përvojë se paku një (1) vjeçare në fushën e sigurimeve, aktiviteteve tjera financiare apo përvojë menaxheriale në subjektet tjera biznesore të madhësisë së ngjashme me kompaninë e ndërmjetësimit.
- drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për obligimet që marrin dhe ju besohen dhe që ata propozojnë t'i kryejnë për të mirën e interesave të policëmbajtësve, si dhe të kornizës ligjore sipas të cilës operojnë ndërmjetësuesit e sigurimeve në Kosovë;
- drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të dëshmojnë përmbushjen e shpejtë të obligimeve të kaluara financiare dhe gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare.

Pika 2.2.3. e këtij kapitulli aplikohet për degët e kompanive ndërmjetësuese të jashtme, vetëm sa i përket menaxherëve të lartë të degës në Kosovë.

2.2.4. Letrat mbështetëse

Në rastet kur aplikuesit janë të interesuar të themelojnë një degë apo subjekt të varur të një kompanie ndërmjetësuese të jashtme, BQK kërkon nga aplikuesit një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të aktiviteteve të propozuara në Kosovë, dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar të veprimtarisë ndaj kompanisë ndërmjetësuese të jashtme (nëse është e aplikueshme). Në rastet kur legjislacioni i vendit amë të kompanisë ndërmjetësuese të jashtme, kërkon miratim paraprak për rastet e hapjes së subjekteve të varura dhe degëve jashtë juridiksionit të tij, atëherë duhet të sjellët në BQK shkresa aprovuese.

Gjithashtu në këto raste BQK kërkon edhe një letër mbështetëse nga kompania ndërmjetësuese e jashtme (kompania amë e aplikuesit për licencë), drejtuar BQK-së të formuluar minimalisht si në formën e mëposhtme: (BQK ja mund të kërkojë nga kompania ndërmjetësuese e jashtme amë që të freskojë këtë letër kohë pas kohe)

Në rastin e subjekteve të varura letra mbështetëse duhet të ketë përmbajtjen si në vijim: “Ne ju shkruajmë për të konfirmuar se [emri i ndërmjetësuesit potencial] është një subjekt i varur, në pronësi të plotë të [emri i

² Në rrethana të veçanta, pasi që të jetë e kënaqur me kualifikimet, përvojën profesionale dhe sjelljen e personit, BQK-ja mund ta lirojë një drejtor ose menaxher të lartë nga kjo pikë pas skadimit të periudhës së paraparë për rastin përkatës pas skadimit të periudhës dhjetë vjeçare për rastit përkatës.

ndërmjetësuesit amë]. Struktura e bashkangjitur e grupit tregon zinxhirin e pronësisë në mes *[emri i ndërmjetësuesit amë]* dhe *[emri i ndërmjetësuesit potencial]*.

Është në interesin e *[emri i ndërmjetësuesit amë]* se *[emri i ndërmjetësuesit potencial]* vazhdon të përmbushë gjatë gjithë kohës detyrimet dhe obligimet e saja që ka ndaj klientëve.

Prandaj ne e njohim përgjegjësinë mbi të dhe obligimet juridike të cilat mund të ekzistojnë për të mbrojtur stabilitetin financiar të saj. Përmes kësaj letre ju sigurojmë se *[emri i ndërmjetësuesit amë]* është gjithmonë në gjendje të përmbushë detyrimet e *[emri i ndërmjetësuesit potencial]* dhe konfirmojmë se *[emri i ndërmjetësuesit amë]* do të përmbushim këtë përgjegjësi.

2.2.5. Dorëzimi i aplikacionit

Pas mbajtjes së takimit informues dhe shqyrtimit të fazës së aplikimit në këtë manual aplikuesit duhet të jenë të gatshëm të dorëzojnë aplikacionin formal për licencim në BQK si ndërmjetësues në sigurime. Para se të dorëzohet aplikacioni, aplikuesit duhet ta rishikojnë atë për të kontrolluar nëse kanë dhënë përgjigje adekuate për të gjitha pyetjet dhe kanë bashkangjitur të gjitha dokumentet mbështetëse.

Është e rëndësishme që aplikuesit të kenë parasysh që gjithmonë të jenë të hapur dhe të sinqertë me BQK-në, meqë sukcesi i aplikimit do të ndikohet nëse BQK kupton që aplikuesit kanë mbajtur qëllimisht informacione ose kanë dhënë fakte të rreme ose jo të plota. Aplikuesit gjithashtu duhet të ndajnë me BQK-në ndonjë informacion tjetër që mendojnë se BQK duhet të jetë në dijeni. Nëse aplikuesit janë në dyshim për ndonjë gjë, atëherë ata lutën ta ndajnë atë me BQK-në. Gjithashtu, BQK ju rekomandon aplikuesve që t'i adresojnë të gjitha çështjet dhe veprimet që BQK ka identifikuar me ta gjatë fazës së para-aplikimit përpara se të dorëzojnë aplikacionin e tyre. Nëse informacioni që aplikuesit japin është i pasaktë, ose i paplotë, kjo, në minimum, do të vonojë aplikimin e tyre.

Aplikacionet për licencë për zhvillim të aktivitetit ndërmjetësues së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Sigurimet, Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime me aktet e brendshme të BQK-së dorëzohen në formë të shkruar në BQK. Si pjesë përbërëse e aplikacionit duhet të plotësohet **Formulari³ i aplikimit për licencë të aktivitetit ndërmjetësues** që gjendet si Shtojcë 2 e këtij manuali si dhe në faqen zyrtare të BQK-së (www.bqk-kos.org). Ky Formulari duhet të nënshkruhet nga të gjithë aksionarët themelues dhe të dorëzohet në BQK me prezencë fizike të përfaqësuesve të aksionarëve themelues të ndërmjetësuesit të propozuar ose të ndërmjetësuesit të jashtëm në rastet kur ata janë të interesuara për hapjen e një dege në Kosovë.

Dokumentacioni i ofruar si pjesë përbërëse e aplikacionit duhet të jetë në njërin nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti të huaj, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të atij shteti të huaj dhe në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse të ligjeve të tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Për shqyrtimin e aplikacioneve për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime, BQK-ja ka caktuar tarifa përkatëse bazuar në nenin 130 të Ligjit mbi Sigurimet. Të gjitha tarifat e kërkuara të aplikimit janë të paraqitura në Skemën e Tarifave që gjendet në ueb-faqen zyrtare të BQK-së dhe janë të pakompensueshme,

³ Ky formular nuk aplikohet për ndërmjetësuesit që aplikojnë për tu licencuar si individ.

pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen, nëse tarifa e licencimit nuk është paguar.

2.3. Faza e pas-aplikimit

Kompanitë ndërmjetësuese, degët e ndërmjetësuesve të jashtëm, aktiviteti shtesë i ndërmjetësimit

Pas dorëzimit formal të aplikacionit për licencim të aktivitetit ndërmjetësues, BQK bën vlerësimin e parë ku verifikohet nëse aplikacioni i dorëzuar është i plotë ose jo. Që aplikacioni të vlerësohet i plotë, duhet të dorëzohen në BQK të gjitha format e kërkuara, të cilat duhet të jenë plotësuar plotësisht dhe në mënyrë korrekte dhe informacioni i ofruar duhet të jetë i cilësisë dhe detajeve të mjaftueshme për të lejuar BQK-së përfundimin e vlerësimit. Gjithashtu që të vlerësohet i plotë aplikacioni, duhet t'i ketë të inkuorporuara përgjigjet ndaj komenteve të BQK-së të ofruara gjatë fazës së para-aplikimit.

Në pajtim me nenin 13 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, vlerësimi i parë bëhet nga BQK brenda 90 ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, dhe BQK e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është i kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar apo nëse kërkohen informata shtesë, BQK do ta njoftoj aplikuesin për mangësitë apo mospërputhjet me legjislacionin në fuqi së bashku me kërkesën për informata apo dokumentet shtesë që kërkohen. Gjatë kësaj periudhe, BQK mund të mbajë takim me aplikuesit për të marrë ndonjë informacion shtesë ose ndonjë ndryshim në lidhje me kërkesën. Gjatë këtyre takimeve do të mbahen procesverbale të cilat do të regjistrohen në dosjen e aplikacionit. Vlen të ceket që BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme në çfarëdo faze të procesit të licencimit.

Afati për paraqitjen e informatave apo dokumenteve shtesë është jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit. Nëse informatat apo dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. Në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 30 ditësh pas datës së njoftimit, BQK ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.

BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon dhënien e licencës ndërmjetësues në sigurime brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar.

Ndërmjetësuesit individual (persona fizik)

Në pajtim me nenin 13 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, Vlerësimi i parë bëhet nga BQK brenda 30 ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit (kërkesës), dhe BQK e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është i kompletuar. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar apo nëse kërkohen informata shtesë, BQK do ta njoftoj aplikuesin për mangësitë apo mospërputhjet me legjislacionin në fuqi së bashku me kërkesën për informata apo dokumentet shtesë që kërkohen. Gjatë kësaj periudhe, BQK mund të mbajë takim me aplikuesit për të marrë ndonjë informacion shtesë ose ndonjë ndryshim në lidhje me kërkesën. Gjatë këtyre takimeve do të mbahen procesverbale të cilat do të regjistrohen në dosjen e aplikacionit. Vlen të ceket që BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme në çfarëdo faze të procesit të licencimit.

Afati për paraqitjen e informatave apo dokumenteve shtesë është jo më vonë se 30 ditë nga data e njoftimit. Nëse informatat apo dokumentet shtesë të kërkuara janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar. Në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 30 ditësh pas datës së njoftimit, BQK ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit (kërkesës) për licencim. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit kërkesës për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.

BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon dhënien e licencës ndërmjetësues në sigurime (persona fizik) brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar.

2.4. Procesi i shqyrtimit

Kompanitë ndërmjetësuese, degët e ndërmjetësuesve të jashtëm, aktiviteti shtesë i ndërmjetësimit

Pas vlerësimit të parë të aplikacionit, verifikimit që aplikacioni është kompletuar si dhe informimit të aplikuesit për këtë çështje, BQK fillon me vlerësimin e dytë kur edhe bëhet shqyrtimi i thellë analitik i aplikacionit. Ky vlerësim i mundëson BQK-së përcaktimin nëse ndërmjetësuesi i propozuar do të operojë në një mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme dhe do të këtë mundësi të arsyeshme të suksesit. Vlerësimi bëhet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim si dhe nga Divizioni i Raportimit dhe Analizave në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve përgjegjësia e të cili është vlerësimi i Planit të Biznesit të ndërmjetësuesit të propozuar marrë parasysh faktin që posedojnë të gjitha informatat dhe raportet analitike të industrisë siguruese.

Vlerësimi gjithmonë do të bazohet në informatat e dorëzuara me aplikacion si dhe në informatat tjera që janë në dispozicion të BQK-së si rezultatet e aktiviteteve të saj mbikëqyrëse. Gjithashtu, BQK-ja do të kërkojë referencat dhe mendimet e nevojshme nga autoritetet mbikëqyrëse vendore nga vjen ndërmjetësuesi i propozuar apo vendet ku kompanitë e grupit janë prezente, kur kjo është e aplikueshme. Informacionet e marra nga BQK-ja gjatë hetimit mund të ndahen me rregullatorët tjerë të institucioneve financiare. Në rast të ndryshimi të informatave të dorëzuara në BQK, aplikuesi duhet të njoftojë BQK-në për ndryshimet e ndodhura pa marrë parasysh se në cilën fazë ndodhet aplikacioni për licencim.

Si rezultat i vlerësimit nëse BQK konstaton mangësi të vogla teknike, apo shpërputhje teknike me kërkesat rregullative, aplikuesi njoftohet për to dhe kërkohet që të ndryshohen në mënyrë që të bëhet i pranueshëm. Procesi i shqyrtimit përmbillet me një raport rekomandues nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim, të cilit i bashkohet edhe rekomandimi i Divizioni i Raportimit dhe Analizave në Departamentin e Mbikëqyrjes së Sigurimeve konform konkluzioneve të nxjerra nga vlerësimi i Planit të Biznesit të ndërmjetësuesit të propozuar. Rekomandimi i paraqitet Zëvendësguvernatorit për Mbikëqyrje Financiare, pastaj i ofrohet Bordit Ekzekutiv të BQK-së për vendimmarrje.

Ndërmjetësuesit individual (persona fizik)

Pas vlerësimit të parë të aplikacionit, verifikimit që aplikacioni është kompletuar si dhe informimit të aplikuesit për këtë çështje, BQK fillon me vlerësimin e dytë kur edhe bëhet shqyrtimi i thellë analitik i aplikacionit. Ky vlerësim i mundëson BQK-së përcaktimin nëse ndërmjetësuesi i propozuar do të operojë në një mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme dhe do të këtë mundësi të arsyeshme të suksesit. Vlerësimi bëhet nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim.

Vlerësimi gjithmonë do të bazohet në informatat e dorëzuara me aplikacion si dhe në informatat tjera që janë në dispozicion të BQK-së si rezultatet e aktiviteteve të saj mbikëqyrëse. Gjithashtu, BQK-ja do të kërkojë referencat dhe mendimet e nevojshme nga autoritetet mbikëqyrëse vendore nga vjen ndërmjetësuesi i propozuar apo vendet ku kompanitë e grupit janë prezente, kur kjo është e aplikueshme. Informacionet e marra nga BQK-ja gjatë hetimit mund të ndahen me rregullatorët tjerë të institucioneve financiare. Në rast të ndryshimit të informatave të dorëzuara në BQK, aplikuesi duhet të njoftojë BQK-në për ndryshimet e ndodhura pa marrë parasysh se në cilën fazë ndodhet aplikacioni për licencim.

Si rezultat i vlerësimit nëse BQK konstaton mangësi të vogla teknike, apo shpërputhje teknike me kërkesat rregullative, aplikuesi njoftohet për to dhe kërkohet që të ndryshohen në mënyrë që të bëhet i pranueshëm. Procesi i shqyrtimi përmbyllet me një raport rekomandues nga Departamenti për Licencim dhe Standardizim. Rekomandimi i paraqitet edhe Zëvendësguvernatorit për Mbikëqyrje Financiar.

2.5. Licencimi

Nëse BQK-ja konstaton se janë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja merr vendim për miratimin e licencës për ndërmjetësues.

2.5.1. Licencimi i kompanive ndërmjetësuese

Licencimi i kompanive të agjentëve

Në pajtim me nenin 112 të Ligjit për Sigurimet dhe nenin 5 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja do të miratoj licencimin e kompanive të agjentëve nëse plotësohen kriteret si në vijim :

- të jetë e regjistruar në regjistrin e bizneseve, si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin për shoqëritë tregtare;
- aksionarët e tij, të jenë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
- të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një agjent të licencuar;
- të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin themeltar në vlerë prej së paku pesë mijë (5,000) euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
- plani i parashikuar i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, duhet të jetë i bazuar në analiza dhe supozime të arsyeshme;
- aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe kryeshefi ekzekutiv, të propozuar, të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguresi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
- aksionarët e kompanisë së agjentëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionar të siguresit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e agjentëve dhe/apo siguresit.

- të këtë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
- të këtë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Licencimi i kompanive të brokerëve

Në pajtim me nenin 114 të Ligjit për Sigurimet dhe nenin 7 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësueve BQK-ja do të miratoj licencimin e Kompanive të Brokerëve nëse plotësohen kriteret si në vijim :

- të jetë i regjistruar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- aksionarët e tij, të jenë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
- aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
- aksionarët e kompanisë së brokerëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionar të siguruesit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e brokerëve dhe/apo siguruesit;
- plani i biznesit për se paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- të këtë të punësuar me kohë të plotë, së paku një broker të licencuar;
- të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin themeltar në vlerë prej së paku dhjetë mijë (10,000) euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
- të këtë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenin 12 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësueve;
- të këtë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

2.5.2. Licencimi i degëve të kompanive të jashtme ndërmjetësuese

Në pajtim me nenin 8 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja do të miratoj licencimin e degëve të kompanive të jashtme të agentëve dhe degëve të kompanive të jashtme të brokerëve, nëse plotësohen kriteret si në vijim:

- të jetë e licencuar si kompani e agentëve ose si kompani e brokerëve, në vendin e origjinës;
- ta këtë miratimin zyrtar për hapjen e degës në Kosovë, nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit të origjinës, nëse sipas legjislacionit të vendit amë kërkohet një gjë e tillë;
- ta këtë miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së agentëve ose kompanisë së brokerimit, për hapjen e degës në Kosovë;

- të prezantoj një letër sigurie e adresuar për BQK-në, nga kompania e agjentëve/kompania e brokerimit amë, me anë të së cilës pranon detyrimin ligjor për pagesën e të gjitha obligimeve të degës së saj në Kosovë;
- të jetë e regjistruar në regjistrin e bizneseve në Republikën e Kosovës, në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
- plani i biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një (1) agjent ose broker të licencuar;
- të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin si fond garantues, në vlerë prej së paku pesë mijë (5,000) euro në rastin e degëve të jashtme të kompanive të agjentëve, ndërsa dhjetë mijë (10,000) euro, në rastin e degëve të kompanive të jashtme të brokerimit. Ky kapital duhet të paguhet në para të gatshme në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe të mirëmbahet në çdo kohë;
- të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të rregullores për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj;
- të ketë para-kontratë të lidhur me siguruesin në emër dhe në llogari të së cilës do të veprojë.

2.5.3. Licencimi i ndërmjetësimit në sigurime si aktivitet shtesë

Licencimi i ndërmjetësimit në sigurime si aktivitet shtesë për bankat

Në pajtim me nenin 10 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja do të miratoj licencimin e aktivitetit shtesë të ndërmjetësimit në sigurime për bankat, nëse plotësohen kriteret si në vijim:

- Bankat që kërkojnë licencë nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, duhet të kenë të punësuar së paku një person që i plotëson kriteret për licencim si agjent ose broker individual, të përcaktuara me Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, varësisht nëse banka do të ushtroj aktivitet të agjenteve ose brokerëve;
- planin e biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe supozime të arsyeshme;
- Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare, ka dhënë opinion me shkrim se gjendja e bankës është e qëndrueshme dhe se angazhimi në aktivitetin e ndërmjetësimit në sigurime nuk pritet të ketë ndikime negative;
- struktura organizative e bankës për aktivitetin e ndërmjetësimit në sigurime, vlerësohet e përshtatshme nga BQK-ja.

Licencimi i ndërmjetësimit në sigurime për produktin sigurimi i shëndetit në udhëtim si aktivitet shtesë për agjencionet e udhëtimit

Në pajtim me nenin 11 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, BQK-ja do të miratojë licencimin e aktivitetit shtesë të ndërmjetësimit në sigurime për produktin e sigurimit të shëndetit në udhëtim, nëse plotësohen kriteret si në vijim:

- Agjencionet e udhëtimit që kërkojnë licencë nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të ndërmjetësimit në sigurime, duhet të kenë të punësuar së paku një person që i plotëson kriteret për licencim si agjent individual, të përcaktuara me Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime;
- planin e biznesit për së paku tri (3) vitet e para të veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime, duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe supozime të arsyeshme;

Faktorët pozitivë që BQK-ja gjithashtu duhet t'i marrë parasysh gjatë vendosjes nëse duhet të miratojë apo refuzojë kërkesat për licencimin e një ndërmjetësuesi janë:

- Perspektivat e fitimeve të ardhshme të ndërmjetësuesit;
- Karakterin e përgjithshëm të menaxhmentit;
- Mjaftueshmërinë e strukturës së saj të kapitalit;
- Nevojat e komunitetit/publikut për shërbime ndërmjetësuese.

3. MIRATIMET E TRANSAKSIONEVE TJERA

Ky kapitull rregullon transaksionet të cilat realizohen pas licencimit të ndërmjetësuesve dhe fillimit të operacioneve të tyre, për të cilat kërkohet miratim paraprak nga ana e BQK-së. Në këtë kapitull është përcaktuar gjithashtu dokumentacioni i kërkuar nga BQK për miratimin e këtyre transaksioneve, afatet si dhe procedura e shqyrtimit. Kapitulli përfundon me specifikimin e transaksioneve për të cilat nevojitet vetëm njoftimi i BQK-së.

Sipas neneve 16 dhe 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, kërkohet miratimi paraprak nga BQK-ja për transaksionet dhe ndryshimet tjera të ndërmjetësuesve, si në vijim:

- ndryshimi i emrit;
- ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit;
- aksionarët kryesor;
- emërimi i drejtorëve (kur është e aplikueshme) dhe menaxherëve të lartë;
- hapja dhe zhvendosja e zyrave brenda dhe jashtë vendit;
- hapja e degëve dhe subjekteve të varura jashtë vendit;
- auditori i jashtëm;
- bashkimet dhe përvetësimet e ndërmjetësuesve.

Kërkesa për miratimin e transaksioneve të lartcekura si dhe dokumentacioni i bashkangjitur në kërkesë duhet të paraqitet nga ndërmjetësuesi dhe duhet të jetë në një nga dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në original ose në kopje të legalizuar.

Në rastet kur kërkesa nuk është e kompletuar apo kërkohen informata shtesë, BQK do ta njoftoj ndërmjetësuesin për mangësitë apo mospërputhjet me legjislacionin në fuqi së bashku me kërkesën për informata apo dokumentet shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave apo dokumenteve shtesë është jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e njoftimit. Në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga ndërmjetësuesi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas datës së njoftimit, BQK-ja njofton me shkrim ndërmjetësuesin për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të kërkesës.

Pasi që kërkesa të konsiderohet e kompletuar BQK e shqyrton dhe vendos për atë kërkesë duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë përshkruar me poshtë në këtë kapitull varësisht nga natyra e transaksionit. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon ndërmjetësuesin. Në rastet e refuzimit, njoftimi për refuzimin e kërkesës do t'i përmbajë arsyet për të cilat është refuzuar kërkesa.

3.1. Ndryshimi i emrit

Ndryshimi i emrit të ndërmjetësuesit kërkon miratim paraprak nga BQK, sipas nenit 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Për miratimin e ndryshimit të emrit, ndërmjetësuesi duhet të dorëzojë në BQK, kërkesë me shkrim duke i bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:

- vendimin e organit vendimmarrës për ndryshim emri; si dhe
- dokumentet për arsyetimin e këtij ndryshimi.

Ndryshimi i emrit, respektivisht emri i ri i propozuar i ndërmjetësuesit duhet të jetë në pajtim me Ligjin për Sigurimet, Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë kërkesën për ndryshimin e emrit.

3.2. Ndryshimet në aktin e themelimit dhe/apo statutit

Asnjë ndërmjetësues, përveç ndërmjetësuesit të jashtëm të licencuar për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë, nuk mund të ndryshojë aktin e tij të themelimit ose statutin pa miratimin paraprak, me shkrim, të BQK-së sipas nenit 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Dega e ndërmjetësuesit të jashtëm i licencuar në Kosovë duhet ta njoftojë BQK-në për çdo ndryshim në aktin e themelimit, statutit apo dokumentacionin ekuivalent të themelimit të ndërmjetësuesit degë e të cilit është, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data efektive e ndonjë ndryshimi.

Për miratimin e ndryshimeve në aktin e themelimit dhe/ose statutit, ndërmjetësuesi duhet të dorëzojë në BQK, kërkesë me shkrim duke i bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesën për miratimin e ndryshimeve në aktin e themelimit dhe/ose statutit;
- Një përshkrim të shkurtër të pikave që propozohet të ndryshohen si dhe një arsyetim se për çfarë arsye po ndryshohen;
- Vendimin e asamblesë së aksionarëve për këtë ndryshim;

- Aktin e themelimit dhe/ose statutin pas ndryshimeve.

BQK aprovon ndryshimet e propozuara në rast se këto ndryshime nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

3.3. Aksionarët kryesor

Struktura e pronësisë së një ndërmjetësuesi është me interes të veçantë, prandaj BQK do të vlerësojë, këtë strukturë si tërësi si dhe përshtatshmërinë individuale të aksionarëve kryesorë ekzistues si dhe atyre potencial të cilët synojnë të jenë pronar të aksioneve në një ndërmjetësues. Zotërimi i aksioneve në një ndërmjetësues, ku një aksionar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi arrin ose tejkalon nivelin e të qenit aksionar kryesor, bëhet vetëm me miratim paraprak të BQK-së pas paraqitjes së kërkesës për të qenë aksionar kryesor. BQK-ja miraton çdo zotërim të mëtejshëm të aksioneve që janë të barabarta ose tej kalojnë dhjetë përqind (10%), njëzet përqind (20%), tridhjetë përqind (30%) dhe pesëdhjetë përqind (50%) të drejtave të votës ose pjesëmarrjes në kapitalin e ndërmjetësuesit.

Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin si në vijim:

- raportin e kompanisë aksionare (RK) apo CV-të e aksionareve individual që gjenden te shtojca B dhe C e këtij manuali;
- emrin, nacionalitetin, vendbanimin dhe historikun afarist the profesional për dhjetë (10) vitet e fundit të paraqitësit të kërkesës, dhe çdo pronari përfitues të paraqitësit të kërkesës që, si rezultat i transaksionit, do të përfitonte në mënyrë indirekte pesë përqind (5%) ose më shumë të interesave të kapitalit të ndërmjetësuesit
- listën e sipërmarrjeve në të cilat pronarët e propozuar, duke përfshirë pronarët përfitues (siç përshkruhet më lartë), kanë pjesëmarrje, duke specifikuar nivelin e pjesëmarrjeve të këtyre dhe adresat e regjistruara të këtyre sipërmarrjeve;
- për çdo person fizik që bën kërkesë, një deklaratë nga Gjykata që shpalos ndonjë dënim për vepra penale nga një gjykatë penale, dosjet personale të falimentimit, përjashtimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e tanishme a të kaluar në funksion menaxhues të një korporate ose të ndonjë sipërmarrësi tjetër që i nënshtrohet procedurës së paaftësisë së pagesës, nëse ekziston;
- për çdo person juridik kandidat, pasqyrat e audituara financiare për tri (3) vitet e fundit;
- afatet dhe kushtet e përvetësimit të propozuar;
- burimin dhe shumën e fondeve që shfrytëzohen në ushtrimin e përvetësimit;
- çdo plan ose propozim lidhur me ndryshimin kryesor në biznesin, strukturën e kompanisë ose menaxhmentin e ndërmjetësuesit;
- në çdo rast kur përvetësimi do të ndikonte që ndërmjetësuesi të bëhet një subjekt i varur i një ndërmjetësuesi të jashtëm, një deklaratë se autoriteti i huaj mbikëqyrës përgjegjës për mbikëqyrje të matur të ndërmjetësuesit të jashtëm në vendin amë nuk kundërshton fillimin e propozuar të aktiviteteve në Kosovë, dhe ushtron mbikëqyrje globale të konsoliduar ndaj ndërmjetësuesit të jashtëm; dhe

- informata të tjera që mund të kërkohen nga BQK-ja.

Gjatë vendosjes për të miratuar një kërkesë për përvetësim të ndërmjetësuesit, BQK-ja vlerëson përvetësimin e propozuar sipas kritereve të njëjta që zbatohen për licencë duke përfshirë por duke mos u kufizuar në efektet e pritura të përvetësimit të propozuar në qëndrueshmërinë financiare të ndërmjetësuesit, strukturën rezultuese të pronësisë së ndërmjetësuesit dhe efektin e saj në mundësinë e BQK-së për të kryer një mbikëqyrje ekskluzive dhe të konsoliduar dhe përshtatshmërinë e aksionarëve të propozuar dhe pozicionin e tyre në tregjet financiare.

BQK-ja mund t'i miratojë aksionarët kryesorë, nëse plotësohen kërkesat e parashikuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe refuzon aprovimin për aksionarët kryesorë nëse gjykon se:

- veprimet e kryera në të kaluarën nga aksionari kryesor apo personat/palët e ndërlidhura me të mund të përkeqësojnë veprimtarinë e ndërmjetësuesit në lidhje me rregullat e menaxhimit të rrezikut apo mund të vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja;
- në rastin e kërkesës nga aksionarët kryesorë të jashtëm, zbatimi i legjislacionit apo praktikave të legjislacionit të vendit të tij, vështirësojnë ose bëjnë të pamundur ushtrimin e mbikëqyrjes nga BQK-ja.
- BQK-ja, nëse gjykon se një person, i cili është aksionar kryesor në një ndërmjetësues vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij Ligji dhe me rregullat për menaxhimin e kujdesshëm e të përshtatshëm të siguruesit, merr masat e duhura për përfundimin e kësaj situate.

Siguruesi gjithashtu duhet ta njoftojë BQK-në për çdo përvetësim të aksioneve brenda pesë (5) ditëve pas përvetësimit të shumës së aksioneve që është e barabartë ose tejkalon pesë përqind (5%) të kapitalit por që nuk tejkalon dhjetë përqind (10 %) të tij. Njoftimi bëhet në atë mënyrë që përmban informacionet që mund të kërkohen nga BQK-ja.

BQK aprovon ndryshimet e propozuara në rast se këto ndryshime nuk janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

3.4. Emërimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

Ndërmjetësuesit mund të administrohen nga bordi i drejtorëve ose jo, varësisht nga forma ligjore e organizimit të tyre e përcaktuar në statut sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Sipas nenit 9 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të ndërmjetësuesit duhet të miratohen paraprakisht nga BQK-ja. Anëtarët e bordit të drejtorëve i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në kapitullin tre (3) të këtij manuali.

Për miratimin e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë ndërmjetësuesit duhet të dorëzojnë informatat e mëposhtme :

- vendimin e organit vendimmarrës për këto emërimet;
- raportin individual (CV sipas shtojcës A të këtij manuali) për personin e emëruar;
- kopjen e legalizuar/noterizuar të përgatitjes shkollore universitare;
- dëshminë zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale, që mund të jetë duke u zhvilluar ndaj personit të propozuar;

- pëlqimin/autorizimin për verifikim të të kaluarës penale dhe marrjen e informacioneve tjera lidhur me informatat e paraqitura;
- informacione tjera shitesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

Drejtorët dhe menaxherët e lartë të propozuar të ndërmjetësuesve, duhet të plotësojnë kriterin “i përshtatshëm dhe i duhur” dhe kriterin për pavarësi ashtu siç është sqaruar edhe në kapitullin tre (3) të këtij manuali. Këto kritere duhet të plotësohen në vazhdimësi për gjatë gjithë kohës deri sa drejtorët dhe menaxherët mbajnë pozitat e tyre në një ndërmjetësues.

BQK-ja i përdorë kriteret e mëposhtme për të bërë vlerësimin para se të japë miratimin e saj për çdo individ të propozuar si drejtor apo menaxher i lartë:

- nuk është larguar nga posti nga një institucion financiar nga BQK-ja; nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
- nuk është përjashtuar ose suspenduar nga autoriteti kompetent nga ushtrimi i profesionit;
- nuk ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një institucioni financiar licenca e së cilës është revokuar apo paaftësia e pagesës ose likuidimi i detyruari tjetër jo vullnetar i së cilës është iniciuar gjatë mandatit të atij drejtori ose menaxheri të lartë.

Gjithashtu, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të propozuar të ndërmjetësuesve duhet të dëshmojnë se posedojnë kriteret e mëposhtme:

- **Integritet** – Historia personale e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të mundshëm duhet të dëshmojë se ata janë plotësisht të pavarur dhe se posedojnë kualitete personale, në rend të parë integritetin që është i nevojshëm për t’i kryer detyrat e tyre.
- **Gjykim** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë kualifikimet e duhura formale dhe aftësi personale që i japin mundësi atyre, që në mënyre kritike dhe adekuate të vlerësojnë politikat e rëndësishme dhe çështjet strategjike, me të cilat do të ballafaqohet ndërmjetësuesi dhe të artikulojnë qartë pikëpamjet e tyre mbi çështjet e tilla.
- **Udhëheqja** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë përvojë të mjaftueshme të udhëheqjes në biznes.
- **Kompetenca** – Drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë, duhet të kenë të përfunduar studimet universitare dhe të kenë përvojë së paku një vjeçare në fushën e sigurimeve, aktiviteteve tjera financiare apo përvojë menaxheriale në subjektet tjera biznesore të madhësisë së ngjashme me kompaninë e ndërmjetësimit.
- **Qëndrueshmëria financiare** – Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të dëshmojnë përmbushjen me kohë të obligimeve financiare.
- **Mjedis ligjor** – njohuri të kornizës ligjore sipas të cilës operojnë ndërmjetësuesit dhe ndërmjetësuesit në Republikën e Kosovës.

Për më tepër, BQK-ja mund të zgjedhë të intervistojë ndonjë drejtor apo menaxher të lartë të propozuar.

BQK vendos për kërkesat sipas kësaj pike, brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar

3.5. Hapja e degëve të reja dhe zhvendosja e zyrave brenda vendit

Ndërmjetësuesit që vendosin të zgjerojnë aktivitetin e tyre, duke hapur degë të reja ose zhvendosur zyrat, përfshirë selitë qendrore, duhet që paraprakisht të marrin miratim nga BQK-ja, siç edhe përcaktohet me nenin 16 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Për miratimin e hapjes dhe zhvendosjes së degëve dhe zyrave brenda vendit, ndërmjetësuesit duhet të dorëzojnë kërkesë me shkrim në BQK së bashku me informatat e mëposhtme:

- Formulari i aplikimit sipas shtojcës 3 të këtij manuali;
- një përshkrim i aktiviteteve të planifikuara të degës/zyrës;
- marrëveshjen/kontratën e qirasë në bazë të së cilës subjekti ka të drejtë të përdorë ambientet ku dega do të kryej veprimtari ndërmjetësuese;
- adresën e saktë të degës apo zyrës së re; dhe
- dëshminë e pagesë së tarifës;
- informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja.

Mjedisi, ku do të ushtrohet veprimtaria e ndërmjetësuesit, duhet të plotësojë të paktën këto kërkesa:

- të ketë hapësirë të nevojshme dhe kushte të përshtatshme për mirëmbajtjen e dokumentacionit, pajisjeve të punës dhe komunikimit me klientët. Hapësira e punës duhet të jetë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) metra katror;
- të ketë pajisjet e nevojshme teknike për ushtrimin e veprimtarisë dhe tabelë ku paraqiten të dhënat mbi agentin, miratimin e tij nga BQK-ja dhe çmimet/primet e të gjitha produkteve të sigurimit të cilat mund t'i ofrojnë.

BQK-ja mund të kryej inspektimi në degët/zyrat e ndërmjetësuesve ku planifikohet të ushtrohet aktiviteti, para ose pas miratimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës dhe kryerjes së ekzaminimit të parahapjes, BQK-ja vendos për miratimin apo refuzimin e kërkesës duke u bazuar në kriteret e mëposhtme brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar.

BQK-ja ka të drejtë të pezullojë ushtrimin e veprimtarisë së zyrave, nëse ajo konstaton se kushtet teknike për ushtrimin e veprimtarisë, nuk janë përmbushur. Në raste të tilla, përveç pezullimit për ushtrimin e veprimtarisë së zyrave, BQK-ja do të ndërmarr edhe masa të tjera ndëshkuese ndaj ndërmjetësuesit, të parapara sipas legjislacionit në fuqi.

3.6. Hapja e degëve ose e subjekteve të varura jashtë vendit

Sipas nenit 16 paragrafi 1 të Rregullores për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, kompanitë ndërmjetësuese në sigurime, para se të themelojnë një subjekt të varur ose hapin një degë në ndonjë juridiksion tjetër duhet të marrin miratim paraprak nga BQK-ja.

Kërkesa për hapjen e degëve jashtë vendit, duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- formulari i aplikimit sipas shtojcës 4 të këtij manuali (Formulari i aplikacionit për hapjen e një dege/subjekti të varur jashtë Kosovës);
- vendimin e organit vendimmarrës të kompanisë ndërmjetësuese për miratimin e këtij zgjerimi jashtë Republikës së Kosovës;
- vendndodhjen dhe zonën e ushtrimit të veprimtarisë nga dega e propozuar;
- shumën e kapitalit që do të investohet jashtë vendit, si dhe pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës si dhe shpenzimet e tjera operative;
- informacionin për personin/at e propozuar si drejtues të degës, të shoqëruar me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tij;
- emërtimin, e propozuar për t'u përdorur nga dega, që duhet të korrespondojë me emërtimin e kompanisë ndërmjetësuese; dhe
- informata të tjera që mund të konsiderohen të nevojshme nga BQK-ja.

Degët e kompanive ndërmjetësuese që hapen jashtë territorit të Republikës së Kosovës mund të kryejnë vetëm ato veprimtari, për të cilat kompania ndërmjetësuese është e licencuar në Kosovë.

Për të themeluar një subjekt të varur jashtë Republikës së Kosovës, kompania ndërmjetësuese duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim në BQK të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- dokumentacioni që kërkohet për themelimin e degës jashtë Republikës së Kosovës, të përshkruar me lartë në këtë pikë;
- plani i biznesit i subjektit të varur dhe parashikimi për ndikimin e zgjerimit të rrjetit në gjendjen financiare të kompanisë ndërmjetësuese, për tre vitet e para të veprimtarisë;
- informacion për bordin e drejtoreshave dhe menaxherët e lartë të subjektit të varur;
- informacion për identitetin, vendqëndrimin/rezidencën ose selinë si dhe të dhënat tregtare të vitit të fundit për çdo person që do të zotërojë pjesëmarrje influencuese në subjektin e varur;
- veprimtaritë ndërmjetësuese që subjekti i varur parashikon të kryej.

Emërtimi i subjektit të varur jo domosdoshmërisht duhet të korrespondojë me emërtimin e kompanisë ndërmjetësuese amë.

Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike prej datës së pranimit të aplikacionit të kompletuar për degë ose subjekt të varur, BQK-ja duhet të miratojë ose të refuzojë kërkesën.

3.7. Auditori i jashtëm

Kompanitë ndërmjetësuese për emërimin e auditorëve të jashtëm duhet të marrin miratim paraprak nga BQK-ja, siç përcaktohet me nenin 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime dhe

Rregulloren për Auditimin e Jashtëm të Siguruesve, Ndërmjetësuesve në Sigurime, Trajtuesve të Dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit

Në pajtim me nenin 4 të Rregullores për Auditimin e Jashtëm të Siguruesve, Ndërmjetësuesve në Sigurime, Trajtuesve të Dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit, ndërmjetësuesi, së bashku me aplikacionin për miratim, duhet t'i sigurojë BQK-së:

- propozimin e bordit të drejtorëve ose të organit përkatës të ndërmjetësuesit mëmë në rastin e degës së ndërmjetësuesit të jashtëm, për emërimin e auditorit të jashtëm;
- programin e auditimit të ndërmjetësuesit;
- përshkrimin e shfrytëzimit të burimeve gjatë shërbimit të auditimit;
- letrën e angazhimit të auditorit të jashtëm ose kontratën e shërbimit të ofruar;
- dokumentin që vërteton përvojën e mjaftueshme të auditorit të jashtëm apo të stafit të tij i cili kryen auditimin në fushën e auditimit të siguruesve apo institucioneve të tjera financiare;
- vërtetimin e lëshuar nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) në lidhje me rezultatet e kontrollit të fundit të cilësisë për auditorin e jashtëm (ky vërtetim nuk do të kërkohet nga BQK-ja derisa KKRF të mund të lëshojë një vërtetim të tillë).

Aplikacionet për miratim duhet të dorëzohen në BQK para datës 30 korrik të secilit vit. Punësimi i vazhdueshëm i auditorit të jashtëm të njëjtë është i kufizuar në pesë (5) vite apo pesë (5) auditime të njëpasnjëshme, ndërsa mund të rimarrë pjesë në auditimin e të njëjtut ndërmjetësues pas mbarimit të afatit kohor prej të paktën dy (2) vite.

BQK-ja do të aprovojë si auditor të jashtëm të një ndërmjetësuesi vetëm nëse:

- auditori i jashtëm është licencuar në Kosovë në pajtim me Ligjin për raportim financiar;
- auditori i jashtëm ka së paku 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të siguruesve apo institucioneve të tjera financiare apo stafi pjesëmarrës i të cilit kryen auditimin të ketë një eksperiencë të tillë.

Miratimi që i jepet auditorit të jashtëm është i kufizuar për një ndërmjetësues specifik dhe është i vlefshëm për një vit financiar.

Brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar, BQK-ja do të miratojë apo refuzojë kërkesën për auditor të jashtëm.

3.8. Bashkimet dhe përvetësimet

Asnjë ndërmjetësues nuk mund të bashkohet me ndonjë ndërmjetësues tjetër ose të përvetësojë, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, aktiven apo të pranojë pasivën e ndonjë ndërmjetësuesi tjetër, pa miratimin paraprak të BQK-së, siç edhe përcaktohet me nenin 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

Bashkimet

Nëse qëllimi i aplikuesit për bashkim është krijimi i një ndërmjetësuesi të ri, BQK-ja do ta trajtoj atë bashkim si aplikacion për licencë të re ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime.

Kërkesa për miratim për ndërmjetësuesin e riorganizuar nëpërmjet bashkimit duhet të mbështetet nga dokumentacioni në vijim:

- vendimi i asambleve të aksionarëve të ndërmjetësuesve të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit;
- draft-marrëveshja dhe raporti i detajuar i procesit të bashkimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të ndërmjetësuesve të përfshirë në procesin e bashkimit. Draft-marrëveshja dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- draft-statuti i ndërmjetësuesit pas realizimit të procesit të bashkimit;
- planet strategjike dhe operative për të kryer bashkimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për ndërmjetësuesin e bashkuar;
- në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të ndërmjetësuesit të bashkuar, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët, siç është përcaktuar në Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime dhe këtë manual;
- struktura e aksionarëve të ndërmjetësuesit të bashkuar.

BQK miraton procesin e bashkimit nëse:

- bashkimi nuk rrezikon gjendjen financiare të ndërmjetësuesit të bashkuar;
- bashkimi është ekonomikisht i arsyeshëm;
- bashkimi nuk dëmton interesat e kreditorëve të ndërmjetësuesve të përfshirë në proces të bashkimit.

Është përgjegjësi e ndërmjetësuesit për të marrë miratime nga autoritetet e tjera që mund të jenë të nevojshme para se transaksioni të ketë përfunduar. BQK-ja para se të vendosë për bashkimin e ndërmjetësuesve, mund të kërkojë mendimin e agjencionit të konkurrencës.

Përvetësimet

Sipas nenit 19 të Rregullores për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime, përvetësimi i interesit të kapitalit nga ndërmjetësuesit në institucionet financiare nuk mund të bëhet pa aprovim të BQK-së.

Varësisht nga natyra dhe niveli (sa i përket përqindjes së kapitalit që ndërmjetësi planifikon të përfshijë) dhe madhësia e transaksionit ndaj madhësisë së ndërmjetësuesit përvetësues, BQK-ja do të përcaktojë se cilat informata janë të nevojshme para se të mund të shqyrtohet aprovimi.

Në parim, dokumentacioni i kërkuar për shqyrtimin e këtyre kërkesave është si në vijim:

- vendimet përkatëse të asambleve të aksionarëve të ndërmjetësuesit përvetësues dhe institucionit financiar të përfshirë në veprim për aprovimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet përvetësimit;

- marrëveshja/draft dhe raporti i detajuar i procesit të përvetësimit, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjor të subjekteve të përfshirë në procesin e përvetësimit. Marrëveshja/draft dhe raporti përpilohen me shkrim dhe në përshtatje me legjislacionin në fuqi;
- raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar në fusha të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e draft marrëveshjes së përvetësimit;
- draft statuti i ndërmjetësuesit përvetësues pas realizimit, të procesit të përvetësimit;
- planet strategjike dhe operative për të kryer përvetësimin, ku përfshihen analizat e nevojshme të përvetësimit dhe parashikimet e pasqyrave financiare për ndërmjetësin përvetësues;
- në rast të ndryshimit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të ndërmjetësuesit përvetësues, duhet të paraqitet dokumentacioni në përputhje me kërkesat për drejtorët dhe menaxherët e lartë siç është e përcaktuar me Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime si dhe më këtë manual;
- struktura e re e aksionarëve të siguruesit përvetësues.

BQK-ja shqyrton aplikacionin nga aspekti i ndikimit në kapitalin e ndërmjetësuesit përvetësues, kapacitetin e menaxhmentit të ndërmjetësuesit përvetësues dhe ndonjë ndryshim të parashikuar në bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë të tij. BQK gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave do të vlerësojë edhe performancën financiare nga ekzaminimi i fundit të bërë në vend të ndërmjetësuesit përvetësues dhe ndërmjetësuesit ose institucionit financiar të përvetësuar si dhe raportet e fundit të auditorit të jashtëm të tyre.

BQK miraton procesin e përvetësimit nëse sipas vlerësimit të saj:

- përvetësimi nuk rrezikon gjendjen financiare të ndërmjetësuesit përvetësues;
- ndërmjetësuesi ka sistem të organizimit, menaxhimit, vendimmarrjes dhe teknologjisë informative e cila mundëson integrimin e plotë të institucionit të përvetësuar në atë mënyrë që të mos e rrezikojë funksionimin e tij;
- përvetësimi është ekonomikisht i arsyeshëm për ndërmjetësin përvetësues;

Afatet e cekura në fillim të këtij kapitulli nuk aplikohen për kërkesat e siguruesve për bashkimet dhe përvetësimet. Për këtë qëllim, BQK-ja, do të diskutojë me siguruesin afatin kohor që do të jetë i nevojshëm për aprovimet paraprake duke lejuar siguruesin, që të fillojë diskutimet me palën tjetër apo palët e tjera të përfshira pa angazhimin e BQK-së. Mirëpo afatet për këto kërkesa nuk mund të kalojnë afatet e parapara në kapitullin dy (2) të këtij manuali.

3.9. Transaksionet që kërkojnë vetëm njoftim të BQK-së

Transaksionet të cilat realizohen pas licencimit të ndërmjetësuesve dhe fillimit të operacioneve të tyre e që për të cilat nuk kërkohet miratim paraprak nga BQK, mirëpo për të cilat kërkohet njoftimi i BQK-së janë si në vijim:

- dorëheqja e anëtarëve të bordit dhe menaxherëve të lartë;
- riemërimi i anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxherëve të lartë;

- ndryshimet në strukturën organizative, nëse ky ndryshim nuk reflektohet në statutin e ndërmjetësuesit;
- ndryshimet në pronësinë e aksionarëve që posedojnë më pak se pesë përqind (5%) të kapitalit;
- përvetësimi i aksioneve nga pesë përqind (5%) deri në dhjetë përqind (10%);
- mbyllja e degëve dhe zyrave të ndërmjetësuesve.

Ndërmjetësuesit duhet të njoftojnë BQK-në brenda tridhjetë (30) ditëve për ndryshimet e ndodhura të specifikuar më lartë. Pas pranimit të njoftimit, BQK-ja informon ndërmjetësuesit për pranimin e njoftimit. Kurse në rastin e mbylljes së degëve dhe zyrave, ndërmjetësuesi duhet ta njoftoj BQK-në se paku tridhjetë (30) ditë para datës së propozuar të mbylljes.

4. SHTOJCAT E APLIKACIONIT

Pjesë përbërëse të këtij manuali janë edhe shtojcat vijuese:

I- Procesi i Licencimit të Ndërmjetësuesve
II- Kriteret e Licencimit të Ndërmjetësuesve

III- Alternativat e Licencimit
IV- Ndërmjetësuesit e Jashtëm (Hua)

1 – Lista Kontrolluese për Plotësimin dhe Dorëzimin e Aplikacionit të Ndërmjetësuesve

2 – Formulari i Aplikimit për Licencimit të Ndërmjetësuesve

3 – Formulari i Aplikimit për Hapjen ose Zhvendosjen e Zyrave të Ndërmjetësuesve

4 – Formulari i Aplikimit për Hapjen e Degëve dhe Subjekteve të Varura Jashtë Vendit

A – CV Individuale
B – Raporti i Aksionarit Kompani (RK)

C – CV për Aksionarët Individualë
D – Format e Projeksioneve Financiare

5. HYRJA NË FUQI

Ky Manual hyn në fuqi në datën e miratimit.


Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

SHTOJCA I – PROCESI I LICENCIMIT TË NDËRMJETËSUESVE NË SIGURIME (NS)



Kur jeni të gatshëm të filloni këtë proces, ju lutem kontaktoni Departamentin e Licencimit dhe Standardizimit për të caktuar takim informues para aplikimit në:

+381 (0) 38 / 222 055 Licencimi@bqk-kos.org

Rr. Garibaldi nr. 33, Prishtinë, Republika e Kosovës



SHTOJCA II – KRITERET E BQK-së PËR LICENCIMIN E NS-ve

Kriteret e licencimit të Ndërmjetësuesve në Sigurime (NS) në Republikën e Kosovës janë përcaktuar në Kapitullin XIX të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet si dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime. Sipas kësaj rregullore, varësisht nga lloji i NS-së, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) miraton licencimin e NS-së kur të plotësohen kriteret e mëposhtme.

1. Kriteret për licencimin e agjentëve në sigurime janë si në vijim:

- të jetë i regjistruar si biznes individual
- të ketë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm;
- të ketë dhënë provimin profesional për agjent;
- të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
- të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg.
- të mos jetë punëtor i rregullt i ndonjë siguruesi;
- të ketë një para-kontratë me një sigurues për të vepruar si agjent i saj;
- të jetë rezident i Republikës së Kosovës;
- të ketë njohuri të njërës nga gjuhët zyrtare të Kosovës;
- të jetë në regjistrin e bizneseve në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- të ketë objekt të përshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit.
- të ketë të paguar tarifën për licencim sipas kësaj rregullore.

Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale dhe certifikata e regjistrimit të biznesit nuk është e obligueshme të dorëzohen në BQK në momentin e dorëzimit të aplikacionit;

2. Kriteret për licencimin e kompanisë së agjentëve janë si në vijim:

- të jetë e regjistruar në regjistrin e bizneseve, si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin për shoqëritë tregtare;
- aksionarët e tij, të jetë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
- të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një agjent të licencuar;
- të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin themeltar në vlerë prej së paku 5,000 euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
- plani i parashikuar i biznesit për së paku tri vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza dhe supozime të arsyeshme;
- aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe kryeshefi ekzekutiv, të propozuar, të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë 6 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
- aksionarët e kompanisë së agjentëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionar të siguruesit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e agjentëve dhe /apo siguruesit.
- të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregullore;
- të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj;

Në rastin kur personi juridik që kërkon të licencohet si kompani e agjentëve, është subjekt i varur i ndonjë kompanie të jashtme të agjentëve, e cila është e licencuar si kompani e agjentëve në vendin e origjinës, duhet të paraqes në BQK edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës (nëse është e aplikueshme) si dhe miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së jashtme të agjentëve.

3. Kriteret për licencimin e brokerave në sigurime janë si në vijim:

- të jetë i regjistruar si biznes individual;
- të ketë të përfunduar studimet universitare;
- të ketë dhënë provimin profesional për broker;
- të ketë përvojë pune së paku njëvjeçare në fushën e sigurimeve apo të ketë përvojë pune së paku dy vjeçare në fushën e shërbimeve financiare;
- të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg;
- të mos jetë i punësuar në ndonjë sigurues;
- të mos ketë qenë kryeshef ekzekutiv apo anëtar i bordit të ndonjë siguruesi, gjatë 6 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;

- të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- të mos ketë obligime tatimore të papaguara me kohë;
- të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
- të ketë paguar provizionin për licencim sipas kësaj rregulloreje;
- të ketë objekt të përshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e ndërmjetësimit.

4. Kriteret për licencimin e kompanive të brokerimit janë si në vijim:

- të jetë i regjistruar si shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- aksionarët e tij, të jenë në gjendje të mirë financiare dhe të mos kenë obligime tatimore të papaguara me kohë;
- aksionarët, drejtorët (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherët e lartë të propozuar të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për veprë penale, me gjashtë (6) muaj apo më shumë burg si dhe të mos kenë qenë drejtor ose kryeshef ekzekutiv të ndonjë siguruesi gjatë 6 muajve të fundit nga momenti i aplikimit;
- aksionarët e kompanisë së brokerëve nuk duhet të jenë njëkohësisht edhe aksionar të siguruesit, pavarësisht përqindjes që e kanë në kompaninë e brokerëve dhe /apo siguruesit.
- plani i biznesit për se paku tri vitet e para të veprimtarisë, i cili duhet të jetë i bazuar në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- të ketë të punësuar me kohë të plotë, së paku një broker të licencuar;
- të paguajë dhe mirëmbajë në çdo kohë kapitalin themeltar në vlerë prej së paku 10,000 euro. Ky kapital duhet të paguhet në një nga bankat e licencuara nga BQK-ja dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera;
- të ketë policë të sigurimit nga përgjegjësia profesionale sipas përcaktimeve të nenit 12 të kësaj rregulloreje;
- të ketë objekte të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj.

Në rastin kur personi juridik që kërkon të licencohet si kompani e brokerimit, është subjekt i varur i ndonjë kompanie të jashtme të brokerimit e cila është e licencuar si kompani e brokerimit në vendin e origjinës, duhet të paraqes në BQK edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës (nëse është e aplikueshme) si dhe miratimin zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së jashtme të brokerimit, për hapjen e subjektit të varur në Kosovë.

5. Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime nga bankat:

Veprimtaria e ndërmjetësimit në sigurime mund të ushtrohet edhe nga bankat pas licencimit nga BQK. Veprimtaria e ndërmjetësimit nga bankat mund të bëhet vetëm nga të punësuarit e tyre të cilët i plotësojnë

kriteret për licencim të specifikuar më lartë në kriteret për licencimin e agjentëve/brokerëve dhe që janë të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar këtë veprimtari.

6. Kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime nga agjencionet e udhëtimit

Agjencionet e udhëtimit mund të ushtrorjnë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime si agjentë të siguresve, vetëm për sigurimin e shëndetit në udhëtim. Veprimtaria e agjentit në sigurime nga agjencionet e udhëtimit për produktin e shëndetit në udhëtim duhet të bëhet nga persona që i plotësojnë kriteret për licencim të specifikuar më lartë në kriteret për licencimin e agjentëve dhe që janë të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar këtë veprimtari.



SHTOJCA III – ALTERNATIVAT E LICENCIMIT TË NS-ve

Ndërmjetësimi në sigurime është veprimtaria e prezantimit, propozimit dhe kryerjes së aktiviteteve të tjera përgatitore, deri në nënshkrimin e kontratës së sigurimit, si dhe dhënien e asistencës gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës, veçanërisht në rast dëmi, përderisa veprimtaria e sigurimit është veprimtari përmes së cilës siguruesi merr përsipër rreziqe të caktuara, përkundrajt pagesës së primit, që me rastin e ndodhjes së ngjarjes së siguruar t'i paguajë të siguruarit, përfituesit apo palës së tretë dëmshpërblimin.

Ndërmjetësuesit në Sigurime (NS) mund të ofrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit përmes dy llojeve të institucioneve, agjentëve dhe brokerëve. Agjent në sigurime është personi, i licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe i punësuar ose kontraktuar nga siguruesi, që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime në llogari të siguruesve. Ndërsa broker në sigurime është personi i licencuar nga BQK-ja që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime në llogari të të siguruarve me një ose më shumë siguruesve me të cilët ka marrëdhënie kontraktuale.

Agjentët në sigurime mund të licencohen si agjent individual apo kompani e agjentëve. Agjentët janë persona fizik të organizuar si shoqëri tregtare dhe të kontraktuar nga siguruesi, apo shoqëria e agjentëve, që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime. Kompanitë e agjentëve janë persona juridik të licencuar nga BQK-ja dhe të kontraktuar nga një ose më shumë sigurues (po jo për produkte të njëjta), që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime.

Brokerët në sigurime mund të jenë të organizuar si broker individual dhe kompani të brokerimi. Brokerët individual janë persona fizik të organizuar si shoqëri tregtare dhe të kontraktuar nga një ose më shumë sigurues ose një kompani e brokerëve, që të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime. Ndërsa kompania e brokerimit është person juridik i licencuar nga BQK-ja dhe e kontraktuar nga një ose më shumë sigurues, të zhvillojë aktivitetet të ndërmjetësimit në sigurime.

Tiparet tjera dalluese mes agjentëve dhe brokerëve janë si në vijim:

- Agjentet dhe kompanitë e agjenteve kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në llogari të siguruesve.
- Brokerët dhe kompanitë e brokerimit kryejnë veprimtari të ndërmjetësimit në llogari të të siguruarve.
- Agjentët, si persona fizik, nuk lejohet që në të njëjtën kohë të ndërmjetësojnë për sigurues të ndryshëm.
- Kompanitë e agjentëve, mund të licencohen për ushtrimin e aktivitetit të sigurimit jetë dhe jo jetë njëkohësisht, me kusht që këto aktivitete të ushtrohen ndaras nga agjentë të licencuar për të ndërmjetësuar sigurim jetë respektivisht jo jetë.
- Kompanitë e agjentëve mund të ndërmjetësojnë për më shumë se një sigurues në të njëjtën kohë, me kusht që klasat e sigurimeve që ndërmjetësojnë nuk janë të njëjta. Në raste të tilla, kompania e agjentëve duhet të siguroj miratimin e BQK-së.
- Brokerët dhe kompanitë e brokerimit mund të licencohen për ushtrimin e aktivitetit të sigurimit jetë dhe jo jetë njëkohësisht.



SHTOJCA IV – NDËRMJETËSUESIT E JASHTËM (HUAJ)

Ndërmjetësuesi i jashtëm është personi juridik që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licencë për tu angazhuar në veprimtari të sigurimeve në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës. Ndërmjetësuesit e jashtëm mund të operojnë në Kosovë si subjekte të varura filial apo degë.

Tiparet dalluese

Tiparet dalluese në mes të filialeve dhe degëve të ndërmjetësuesve të jashtë janë të natyrave të ndryshme, qoftë nga aspekti i organizimit apo nga aspekti i mbikëqyrjes. Fillimisht, filial nënkupton një subjekt të varur të ndërmjetësuesit të huaj, që është nën kontroll të përbashkët me këtë ndërmjetësues, ndërsa degë e ndërmjetësuesit të jashtëm nënkupton një subjekt ligjërish të varur të ndërmjetësuesit të jashtëm i pa themeluar me vete, nëpërmjet të cilës ndërmjetësuesi i jashtëm angazhohet në veprimtari ndërmjetësuese në Republikën e Kosovës.

Filiali i siguruesit të jashtëm i nënshtrohet të gjitha kërkesave ligjore të përcaktuara me Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet në mënyrë të njëjtë sikurse ndërmjetësuesit vendor. Për dallim nga filialet, degët e ndërmjetësuesve të jashtëm nuk iu nënshtrohen kërkesave ligjore në vijim:

- Kriteret për anëtarët e bordit të drejtorëve si dhe ndryshimet në anëtar të bordit të drejtorëve nuk aplikohet për degët ndërmjetësuesve të jashtëm. Degës së ndërmjetësuesit të jashtëm nuk do t'i kërkohej të themelojë Bord në Kosovë.
- Kërkesat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) për themelimin e komiteteve nuk zbatohen për degët e ndërmjetësuesve të jashtëm për aq kohë sa kërkesat e krahasueshme dhe të pranueshme për BQK-në zbatohen me ligj sipas të cilit ndërmjetësuesi i jashtëm është licencuar në juridiksionin e tij amë;
- Miratimi i aksionarëve kryesor nuk kërkohej për degët e ndërmjetësuesve të jashtëm, po vetëm njoftim i BQK-së.
- Ndryshimet në aktin e themelimit dhe statut, nuk kërkojnë miratim paraprak nga BQK, por vetëm njoftim.

Ndërmjetësuesi, i cili ushtron veprimtari ndërmjetësimi në territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degës së tij, në bazë të licencës së lëshuar nga BQK-ja, mund të shndërrojë degën e tij në një subjekt të varur, në formën e personit juridik, me kërkesë të vet ndërmjetësuesit ose me kërkesë të BQK-së.

Në rastin kur ndërmjetësuesi kërkon që degën ta shndërrojë në subjekt të varur, siguruesi duhet ta marrë edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit të tij. Pas aprovimit të shndërrimit dhe lëshimit të licencës së re, të gjitha të drejtat dhe obligimet e degës së siguruesit të jashtëm, i kalojnë subjektit të varur pasardhës.



SHTOJC

LISË E KUSHTETUESË PËR
PLOTËSIMIN E DOKUMENTIT PËR
KËRKIMIN PËR
LICENCIMIN E
NDËRMJETËSUESVE NË
SIGURIME

1.5 SHËNIME

Ky formular shërben si listë kontrolluese për plotësimin dhe dorëzimin e aplikacionit për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime, i cili mund të shkarkohet edhe nga ueb faqja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Gjatë plotësimit, ju nuk duhet të ndryshoni apo fshini ndonjë pyetje. Nëse plotësimi i këtij formulari nuk është i mundur përmes kompjuterit, atëherë të njëjtin mund ta shtypni dhe plotësoni me SHKRONJA TË MËDHA DHE NGJYRË TË KALTËRT.

Kërkesa për informata të paraqitura në listën e kontrolluese duhet t'i ofrohen BQK-së në mbështetje të aplikacionit për licencë të ndërmjetësuesve në sigurime. Të gjitha informacionet e listuara duhet të sigurohen në mënyrë që të përbëjnë një aplikacion të kompletuar. Lista kontrolluese nuk nënkupton që t'iu referohemi gjerësisht të gjitha informacioneve përkatëse lidhur me aplikimin për licencë të ndërmjetësuesve në sigurime por aplikuesi duhet të zgjerohet në informacionin e kërkuar kur është e nevojshme, sipas natyrës së veçantë të biznesit të propozuar.

Shënim:

- Përfundoni të gjitha seksionet e kësaj liste kontrolluese.
- Vendosni numrin relevant të seksionit (nga aplikacioni) në kolonën e titulluara “Aplikuesi”. (Kolona e fundit është vetëm për përdorim të BQK-së)
- Nëse se ndonjëra nga kërkesat e kësaj liste nuk aplikohet në rastin tuaj shkruaj N/A.
- Aty ku lista kontrolluese thotë “konfirmo”, vendos ‘X’ nëse konfirmoni.

		Aplikuesi		BQK
1	Detajet e Aplikuesit			
1.1	Emri i plotë dhe adresa në formularin e aplikacionit			
1.2	Detajet e kontaktimit të personit të autorizuar që do të shërbejë si person kontaktues me BQK-në lidhur me aplikacionin (d.m.th. emri, adresa, telefoni, adresës elektronike, etj.)			
1.3	Detajet e kontaktimit të këshilltarëve profesional apo konsulentëve në lidhje me aplikacionin për licencim (nëse është i aplikueshëm), (d.m.th. emri, adresa, telefoni, adresës elektronike, etj.)			
1.4	Konfirmoni që BQK-ja mund të bashkëpunojë me këshilltarët profesional të emëruar (në 1.3) në lidhje me aplikacionin për licencim	<input type="checkbox"/>		

2	Pasqyra e Ndërmjetësuesit Amë/Grupit			
2.1	Emri i plotë dhe adresa e ndërmjetësuesit amë/grupit			
2.2	Historiku i shkurtë/historiku i ndërmjetësuesit amë/grupit			
2.3	Sqarime për pronësinë dhe strukturën e ndërmjetësuesit amë/grupit			
2.4	A është aplikuesi subjekt i varur	Po/Jo		
	a. I një ndërmjetësuesi ndërkombëtare	<input type="checkbox"/>		
	b. I një grupi ndërmjetësuesish ndërkombëtar	<input type="checkbox"/>		
	c. I një konglomerati financiar	<input type="checkbox"/>		
	d. Tjetër (siguro detajet)	<input type="checkbox"/>		
	Aty ku është e aplikueshme			
	i. Konfirmoni që autoriteti mbikëqyrës nga vendi amë i këtij ndërmjetësuesi apo grupi ushtron në mënyrë efektive përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse të konsoliduar	<input type="checkbox"/>		
	ii. Konfirmoni që aplikuesi ka marr miratimin paraprak të autoritetit mbikëqyrës të vendit të tij amë	<input type="checkbox"/>		
2.5	Skema organizative e grupit			
	a. Struktura ligjore e secilit nga subjektet në fjalë			

	b. Përqindja e zotërimit të aksioneve nga ndërmjetësuesi amë			
	c. Detaje se ku do të jetë i pozicionuar në grup aplikuesi			
	Në lidhje me ndërmjetësuesin amë/grupin ofron informacion mbi			
2.6	Renditjen në industri, madhësinë e ndërmjetësuesit amë në nivel lokal dhe global			
2.7	Aktivitetet/linjat kryesore të biznesit			
2.8	Detajet e zonave kryesore të aktivitetit global të ndërmjetësuesit amë/grupit			
2.9	Detajet e zonave kryesore të aktivitetit në BE të ndërmjetësuesit amë/grupit			
2.10	Detajet e pozitës financiare të ndërmjetësuesit amë/grupit d.m.th përmbledhja (në format tabelor) për tre (3) vitet e fundit			
	a. Të ardhurat dhe profitabiliteti			
	b. Pasqyrat financiare			
	c. Kualiteti i mjeteve			
	d. Mjaftueshmëria e kapitalit			
	e. Raporti i levës			
2.11	Shkallët e borxhit për ndërmjetësuesin amë/grupin (d.m.th shkalla e borxhit të bankës amë/grupit të Moody`s dhe S&P dhe komentet mbi atë (kjo duhet të përfshijë detajet e çfarëdo përmirësimi/ulje në tre (3) vitet e fundit dhe arsyet për këtë)			
2.12	Konfirmoni se bordi i ndërmjetësuesit amë ka miratuar dorëzimin e aplikacionit për licencim në BQK (duhet të dorëzohet vendimi i organit vendimmarrës)	<input type="checkbox"/>		

3	Rregullatori mbikëqyrës			
3.1	Detajet kontaktuese të rregullatorit/mbikëqyrësit vendor të grupit/ndërmjetësuesit amë			
	Shënoni	Po/Jo		
3.2	A ka marr ndërmjetësuesit amë/grupi brenda pesë (5) viteve të fundit aprovim të rregullatorit për subjekte të reja në ndonjë juridiksion tjetër?			
3.3	A ka aplikuar ndërmjetësuesi amë/grupi për të themeluar subjekt, (gjatë pesë (5) viteve të fundit) në ndonjë juridiksion tjetër i cili është tërhequr apo refuzuar?			
3.4	A ka qenë ndërmjetësuesi amë/grupi subjekt i hetimeve nën akuzat për mashtrim, sjellje të keqe apo keqpërdorim nga ndonjë autoritet rregullator (gjatë pesë (5) viteve të fundit) në ndonjë juridiksion tjetër?			
3.5	Nëse 'po' në lidhje me pikën 3.4 jepni detaje të plota për këtë			

4	Struktura e pronësisë			
4.1	Detajet për			
	a. Të gjithë mbajtësit direkt të aksioneve apo interesave të tjera të aplikuesit			
	b. Të gjithë mbajtësit indirekt të aksioneve/interesave të aplikuesit			

	(Përshkruani qartë nëse ka ndonjë kompani mbajtëse të përfshirë në strukturën e pronësisë – duhet të jepet arsyeja për një strukturë të tillë)			
4.2	Konfirmo që Shtojca B dhe C në formularin e aplikimit janë plotësuar (dhe dokumentacioni i kërkuar mbështetës është i bashkangjitur) në lidhje me secilin aksionar të identifikuar më lartë në 4.1 (a) dhe (b)	<input type="checkbox"/>		
	Konfirmoni që			
4.3	Aplikuesi është i pavarur nga interesi zotërues	<input type="checkbox"/>		
4.4	Gjendja financiare e ndërmjetësuesit amë është e tillë që mund të sigurojë kapital të ri për ndërmjetësuesin në themelim nëse kërkohet në të ardhmen. (Një letër sigurie kërkohet nga ndërmjetësuesi amë që konfirmon që subjekti i varur/ dega do të jetë në pozitë që të plotësojë përgjegjësit e veta, për sa kohë që ndërmjetësuesi amë/aksionarët vazhdojnë të mbajë shumicën e kapitalit)	<input type="checkbox"/>		

5	Objektivat dhe aktivitetet e propozuara			
5.1	Të përcaktuara qartë			
	a. Objektivat			
	b. Detajet e plota të biznesit ndërmjetësues të propozuar nga aplikuesi që duhet të përfshijnë një përshkrim për të gjitha produkteve që do të ofrohen, baza e parashikuar e klientëve, etj.			
5.2	Informacione të detajuara mbi burimet e fondeve për financimin e aktiviteteve të planifikuara (p.sh depozitat etj.)			
5.3	Përshkrimi i të gjitha produkteve/shërbimeve që do të promovohen nga aplikuesi			
5.4	Nëse është e aplikueshme, një vështrim i përgjithshëm i studimeve të tregut që janë ndërmarr sa i përket themelimit të ndërmjetësuesit dhe aktiviteteve të propozuara			
5.5	Rrjeti i shpërndarjes së shërbimeve/produkteve të aplikuesit			

6	Struktura ligjore			
6.1	Konfirmo që aplikuesi do të regjistrohet në Kosovë dhe do t'i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve kosovare	<input type="checkbox"/>		
6.2	Përshkruani strukturën ligjore të aplikuesit			
6.3	Konfirmoni që dokumentacioni i mëposhtëm e shoqëron këtë listë kontrolluese			
	a. Një kopje e dokumentit të themelimit të aplikuesit	<input type="checkbox"/>		
	b. Një kopje e statutit të aplikuesit	<input type="checkbox"/>		
	c. Raportet financiare të audituara për dy (2) vitet e fundit, ku aplikuesi është i inkorporuar	<input type="checkbox"/>		

7	Organizimi i aplikuesit			
	Ndërmjetësuesi duhet të menaxhohet në përputhje me parimet e shëndosha të qeverisjes korporative			
7.1	Bordi i Drejtorëve			

	Detajet e bordit të propozuar të drejtorëve			
	a. Drejtorët ekzekutiv			
	b. Drejtorët joekzekutiv			
	c. Shpeshësia e propozuar e takimeve të bordit dhe vendi			
	d. Konfliktet potenciale të interesit (nëse ka ndonjë, duke përfshirë detajet se si do të adresohen)			
7.2	Gjithashtu për këtë pikë duhet të siguroni			
	a. Struktura organizative e aplikuesit			
	b. Detajet e të gjitha komiteteve të menaxhmentit dhe anëtarët			
	- Komiteti i riskut			
	- Komiteti i mjeteve dhe detyrimeve (“ALCO”)			
	- Komiteti i pajtueshmërisë; nëse është i aplikueshëm			
	- Komiteti i kompensimit, nëse është i zbatueshëm			
	- Komiteti i propozimit, nëse është i zbatueshëm dhe			
	- Komitete të tjera relevante.			
	Këto të dhëna duhet të përfshijnë			
	- Përbërjen e tyre			
	- Shpeshësinë e takimeve			
	- Përgjegjësinë e përgjithshme/ termat e referencave			
	- Linjat e raportimit			
	- Detajet e nën-komiteteve (nëse është e aplikueshme)			
	Menaxhmenti i lartë/ Personeli tjetër			
7.3	Struktura organizative e detajuar e aplikuesit			
7.4	Detaje të strukturës organizative/ekipit të menaxhimit (përfshirë kryeshefin ekzekutiv, zyrtarin kryesor për financa dhe çdo person që i raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë ose ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të bankës), d.m.th. CV, titujt e punës, përgjegjësitë, linjat e raportimit, etj.			
7.5	Konfirmoni që “Shtojca A – CV Individuale” është kompletuar për secilin nga anëtarët e bordit të drejtorëve/manaxhmentit të lartë.			

8	Kapitali, Financimi dhe Aftësia për pagim			
8.1	Kapitali			
	Përcaktoni detajet e plota për			
	a. Kapitalizmin e aplikuesit (në kohën e dorëzimit të aplikacionit) dhe shifrat e projektuara për datën e licencimit (nëse janë planifikuar ndryshimet) – ndarja në mes të kapitalit aksionar, kontributeve në kapital etj.			
	b. Borxhet e varura (nëse është e aplikueshme)			

10	Informacionet Financiare dhe Projektionet			
10.1	Siguroni pasqyra të audituara për grupin për së paku tri (3) vitet e fundit			

	a. Projektionet e pasqyrave e të ardhurave (duke përfshirë shënime për llogaritë)			
	b. Projektionet e bilancit të gjendjes (duke përfshirë shënimet për llogaritë)			
	c. Raportet e kujdeshme & Struktura e Kapitalit			
	d. Projektionet e treguesve kryesor financiar (p.sh kthimin në të ardhura, kostot/të ardhurat etj.).			

11	Informacione tjera të rëndësishme për aplikacionin			

Unë konfirmoj se

- Jam i autorizuar nga aplikuesi për të bërë këtë aplikacion për licencë të ndërmjetësuesit në sigurime në emër të tij;
- Informacioni i dhënë në aplikacion dhe dokumentacionin mbështetës është i kompletuar, korrekt dhe i saktë; dhe
- Është vullneti dhe kapaciteti i aplikuesit që t'i përmbahet kodeve, kërkesave të kujdeshme dhe legjislative të aplikueshme ndaj ndërmjetësuesve në sigurime në baza të vazhdueshme.

Nënshkruar:

Emri:

Titulli:

Emri i punëdhënësit:

Data

/ /

Dispozitat në këtë dokument nuk duhet të fshihen apo të ndryshohen në çfarëdo mënyre. Nëse ndonjë informacion i dhënë është i rremë, BQK-ja mund të revokojë licencën sipas Ligjit Nr. 5/L-045 për Sigurimet.



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

SHTOJCA 2

PROSEDURI E APLIKIMIT
PËR LICENCIM TË
NDËRMJETËSUESVE NË
SIGURIME

SHËNIME UDHËZUESE

Ky formular shërben si aplikacion për licencim të ndërmjetësuesve në sigurime i cili mund të shkarkohet edhe nga ueb faqja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Gjatë plotësimit, ju nuk duhet të ndryshoni apo fshini ndonjë pyetje. Nëse plotësimi i këtij formulari nuk është i mundur përmes kompjuterit, atëherë të njëjtin mund ta shtypni dhe plotësoni me SHKRONJA TË MËDHA DHE NGJYRË TË KALTËRT. Nëse se ndonjëra nga kërkesat e këtij formulari nuk aplikohet në rastin tuaj shkruaj N/A.

Secila pjesë e këtij formulari specifikon edhe dokumentet të cilat duhet të bashkëngjiten. Informacionet dhe dokumentet shtesë mund të sigurohen nëse konsiderohet e nevojshme. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të nënshkruara dhe të kenë datë.

Aplikacioni duhet të përmbajë një listë të përmbajtjeve, duke treguar për secilin seksion të gjitha dokumentet e bashkëngjitura. Në rast se i njëjti dokumentacion kërkohet nga më shumë se një seksion (p.sh. CV-të individuale apo raportet e kompanisë (RK-të), duhet të ofrohen vetëm një herë, duke treguar në të gjitha seksionet relevante se në cilin seksion janë bashkangjitur ato fizikisht.

Në rast se në ndonjërin nga tabelat e mëposhtme në aplikacion, nuk mjaftojnë rreshtat e vendosur, apo tabela përkatëse kërkon të përsëritet, atë faqe mund t'i shtypni më shumë se njëherë.

Ky aplikacion duhet të plotësohet në njërin nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Pasqyrat Financiare dhe dokumentet tjera të bashkëngjitura duhet të dorëzohen në gjuhën e tyre origjinale të shoqëruara me një përkthim të certifikuar në ndonjë gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës.

Përveç nëse kërkohet ndryshe, të gjitha shumat absolute duhet të shprehen në mijëra Euro, pa shifra dhjetore. Konvertimi i valutave të tjera në Euro bëhet duke përdorur kursin e këmbimit në datën e fundit të muajit pasues siç është publikuar nga BQK-ja. Shifrat e përqindjes duhet të shprehen me përdorimin e vetëm një shifre dhjetore.

Personeli i Departamentit për Licencim dhe Standardizim është në dispozicion për konsultime lidhur me rrjedhën e përgatitjes së këtij aplikacioni për licencim dhe do të mundohet të japë udhëzime të duhura aty ku kërkohet. BQK-ja mund të kërkojë, nëpërmjet personelit të Departamentit për Licencim dhe Standardizim, dokumentacion apo shpjegim shtesë që konsiderohen të nevojshme për vlerësim nga BQK-ja.

Nëse aplikacioni është jo i plotë BQK nuk do ta shqyrtoj atë. Gjithashtu, nëse aplikacioni nuk ofron të gjitha informatat e plota që mund të ndikojnë në vlerësimin e BQK-së, kjo në minimum mund të rezultojë në vonesa të konsiderueshme për procesim. BQK-ja nuk mund ta pranojë përgjegjësinë për ndonjë humbje të shkaktuar për aplikuesin nga ndonjë vonesë.

Nëse zbulohet se licenca është dhënë duke u bazuar në informacione të pakompletuara apo fals, BQK-ja mund ta anuloj licencën e dhënë sipas Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet; me tutje “Ligji për sigurimet”.

1. Ndërmjetësuesi Amë**1.1. Emri i ndërmjetësuesit amë****1.2. Vendi ku ndërmjetësuesit amë është inkuorporuar****1.3. Auditori(ët) i jashtëm dhe auditimet për tre (3) vitet e fundit**

VITI	AUDITORI	MENDIMI I AUDITORIT

1.4. Vendet ku ndërmjetësuesit amë është i pranishëm (të dhënat nga pasqyrat e fundit financiare vjetore)

VENDI	AKTIVAT VETANAKE			FITIMET	
	SHUMA	%	PJESËMARRJA NË TREGUN	SHUMA	%
Gjithsej		100.00 %			100.00 %

1.5. Të dhënat kryesore financiare për tre (3) vitet e fundit

VITI	MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT	KLASA I	MJETET TOTALE	FITIMET

1.6. Klasifikimi jashtëm i fundit që i është dhënë ndërmjetësuesit amë

AGJENCIA PËR KLASIFIKIMIN KREDITOR	KLASIFIKIMI AFAT-SHKURTËR		KLASIFIKIMI AFATGJATË	
	KLASIFIKIMI	DATA	KLASIFIKIMI	DATA

1.7. Emri i mbikëqyrësit vendor të ndërmjetësuesit amë**1.8. Data e deklaratës së mbikëqyrësi në vendin amë se nuk ka kundërshtime për themelimin e ndërmjetësuesit në Kosovë**

(asnjë aplikacion nuk do të shqyrtohet pa deklaratë pozitive të mbikëqyrësit në vendin amë)

1.9. Kushtet specifike të deklaratës së mbikëqyrësi në vendin amë, nëse ka ndonjë**1.10. Kufizimet ekzistuese ligjore për shkëmbimin e informatave financiare**

(nëse ka ndonjë, nëse janë specifike për ndërmjetësuesin)

1.11. Kushtet e veçanta të imponuara për të kryer biznes financiar nga çfarëdo autoriteti mbikëqyrës

MBIKËQYRËSI	VENDI	KUSHTET	PERIUDHA

1.12. Data dhe nënshkruesi (emri dhe pozita) i letrës nga ndërmjetësuesit amë që deklaron qëllimin për të themeluar ndërmjetësuesin në Kosovë dhe jep garanci dhe mbështetje**1.13. Aplikimet e mëhershme për licencim të cilat janë refuzuar apo licenca të revokuara (nëse ka ndonjë, një rresht për çdo rast)**

VENDI	MBIKËQYRËSI	DATA	REFUZUAR / REVOKUAR	ARSYET

1.14. Sanksionet e rëndësishme të imponuara në tre (3) vitet e fundit (nëse ka ndonjë, një rresht çdo për rast)

VENDI	MBIKËQYRËSI	DATA	SANKSIONI	ARSYET

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 1:

- Historiku i ndërmjetësuesit amë;
- Certifikata e ligjshme e regjistrimit të kompanisë amë (nëse është e aplikueshme);
- Pasqyrat financiare të audituara për tre (3) vitet e fundit;
- Deklarata nga mbikëqyrësi në vendin amë;
- Letra nga mbikëqyrësi që imponon kushte të veçanta për kryer biznese financiar;
- Letra nga ndërmjetësuesi amë që deklaron qëllimin për të themeluar ndërmjetësuesin në Kosovë, garancitë e veçanta dhe mbështetja e siguruar;
- Dokumentet e ndërlidhura dhe përshkrimet e detajuara të ndonjë licence të refuzuar dhe të revokuar;
- Dokumentet e ndërlidhura dhe përshkrimet e detajuara të ndonjë sanksioni të rëndësishëm të imponuar në tre (3) vitet e fundit.

2. Kompania Aplikuese/Ndërmjetësuesi Potenciale	
2.1. Emri i propozuar i ndërmjetësuesit	
2.2. Lloji i kompanisë (shoqëri aksionare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, etj.)	
2.3. Adresa e selisë së kompanisë	
Rruga	
Qyteti	
Kodi Postar	
Telefoni	
Faksi	
Adresa elektronike	

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 2:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit (nëse është e aplikueshme)

3. Përfaqësuesit e Kompanisë Aplikuese/Ndërmjetësuesi Potenciale						
3.1. Personi i caktuar si zëdhënës i cili do të shërbejë si kontakti fillestar mes kompanisë aplikuese/ndërmjetësuesin potenciale dhe BQK-së:						
EMRI	MBIEMRI	NUMRI I DI-SË	ROLI NË PROCES	ADRESA POSTARE	NUMRI I TELEFONIT	E-MAIL
3.2. Përfaqësuesi ligjorë i kompanisë aplikuese/ndërmjetësuesin potenciale						
EMRI	MBIEMRI	NUMRI I DI-SË	ROLI NË PROCES	ADRESA POSTARE	NUMRI I TELEFONIT	E-MAIL
3.3. Mbështetja nga kompanitë e jashtme dhe profesionistët						
EMRI / KOMPANIA	BISNESI / PROFESIONI	DI / NUMRI I REGJ. TË BIZNESIT	ROLI	ADRESA POSTARE	NUMRI I TELEFONIT	E-MAILI

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 3:

- Kompetencat për përfaqësuesit ligjorë;
- Kopjet e DI-së;
- Përfaqësuesit ligjorë: CV-të, sipas formatit të listuar në Shtojcën A;
- Kompanitë e jashtme: Raportet e kompanisë (RK), sipas formatit të listuar në Shtojcën B;
- Profesionistët e jashtëm: CV-të, sipas formatit të listuar në Shtojcën A.

4.4. Shpjegimi i strukturës së aksionarëve

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 4:

- Aksionarët individual: CV-ja, sipas formatit të listuar në Shtojcën C;
- Aksionarët e kompanisë: Raporti i Aksionarit Kompani (RK), në pajtim me Shtojcën B;
- Skema e strukturës së grupit, përfshirë lidhjet e pjesëmarrjes në mes të kompanive dhe përqindjes së kapitalit;

	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-
	-	-	-

5.6. Auditorët e brendshëm të propozuar dhe pozitat kryesore të kontrollit (përdorni aq rreshta sa është e nevojshme)

EMRI	NUMRI I DI-së	VENDI	DATA E LINDJES	VITET E PËRVOJËS FINANCIARE	POZITA	POZITA NË NDËRMJETSUESIN AMË	NUMRI I TELEFONIT
					Auditori i brendshëm		

DOKUMENTET QË DUHET TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 5:

- Statutin dhe Dokumentin e themelimit;
- Skema e strukturës organizative;
- Përshkrimin e detajuar për komitetet;
- Individët: CV-të sipas formatit të listuar në Shtojcën A, në ueb-faqen e BQK-së.

6. Objektivat e Biznesit	
6.1. Produktet dhe shërbimet financiare që do të ofrohen	- - - - - -
6.2. Segmente kryesore të klientëve që do të ndiqen	- - - - -
6.3. Linjat kryesore të biznesit	- - - -
6.4. Zonat gjeografike që do të mbulohen (rrjeti)	- - - - -
6.5. Kanalet kryesore të shpërndarjes	- - - -
6.6. Vëllimi biznesor i vlerësuar për tre (3) vitet e ardhshme	- - -
6.7. Vlerësimet e profitabilitetit për tre (3) vitet e ardhshme	- - -

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË BASHKËNGJITET NE SEKSIONIN 6:

- Planin e biznesit për tre (3) vitet e ardhshme, duke përfshirë supozimet racionale;
- Projektionet financiare kuantitative për tre (3) vitet e ardhshme në formën e BQK-së të listuar në ueb-faqen e BQK-së (bqk-kos.org) tek Aplikacionet Shtojca D- Forma e projeksioneve financiare.

7. Rreziqet

Përshkrim i shkurtër mbi rëndësinë relative të secilit nga rreziqet e më poshtme duke pasur parasysh linjat kryesore të biznesit të ndërmjetësuesit dhe formën se si ky rrezik do të kontrollohet dhe menaxhohet

Një përshkrim i shkurtër i asaj se sa të rëndësishme janë secila nga rreziqet në vijim që mund të llogaritet në linja kryesore të biznesit të ndërmjetësuesit dhe se si këto rreziqe mund të kontrollohen dhe menaxhohen

7.1. Risku i likuiditetit	
7.2. Risku operacional	
7.3. Rreziqet tjera - - -	

1.6 DOKUMENTACIONI QË DUHET TË BASHKËNGJITET NE SEKSIONIN 7:

- Politika dhe strategjitë e riskut.

8. Mjaftueshmëria e Kapitalit

8.1. Depoziti fillestar ekuivalent i kapitalit për degët

8.2. Kapitali fillestar për ndërmjetësuesit (një rresht për llojin e aksioneve)

KLASA/ LLOJI I AKSIONIT	NUMRI I AKSIONEVE	VLERA NOMINALE	MESATARJA NOMINALE PAR VLERA	PRIMET E KAPITALIT	KAPITALI I PAGUAR	% FILLESTARE E MINIMUMIT TË KAPITALIT	KAPITALI I AUTORIZUAR	% E KAPITALIT TË PAGUAR
GJITHSEJ								

8.3. Raporti i Kapitalit Rregullator (%) e vlerësuar për tre (3) vitet e para

VITI	RAPORTET E KAPITALIT	MJETET E PESHUARA NË RREZIK	KAPITALI RREGULLATIV

DOKUMENTET QË DUHEN TË BASHKËNGJITEN NË SEKSIONIN 8:

- Përshkrim i detajuar për secilin karakteristikë të klasës/llojit të aksioneve;
- Strategjia e kapitalit.

9. Potenciali i Vlerës së Shtuar për Sistemin Financiar të Kosovës

9.1. Vlera e shtuar potenciale e parashikuar nga ndërmjetësuesi i ri në sistemin financiar të Kosovës në lidhje me

Produktet dhe shërbimet financiare në dispozicion	- - - - -
Çmimet dhe normat më të mira për klientët	- - - - -
Qasjes financiare në segmentet specifike të klientëve	- - - - -
Shpërndarja gjeografike	- - - - -
Likuiditeti	
Çështjet të tjera	- - - - -

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË BASHKËNGJITET NË SEKSIONIN 9:

- Analizat e vlerës së shtuar potenciale nga ndërmjetësuesi i ri në sistemin financiar të Kosovës.

Unë/Ne deklarojmë se Ligji për Sigurimet është përmbushur dhe se deklaratat e dhëna këtu dhe dokumentet e dorëzuara këtu janë të vërteta dhe të sakta me diturinë dhe besimin tim/tonë më të mirë. Çfarëdo ndryshimi substancial në veçanti e deklaruara këtu apo në dokumentet në fjalë do t'i komunikohet menjëherë BQK-së brenda një periudhe jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e ndryshimit.

Dështimi për të bërë këtë mund të rezultojë në mosmiratimin e këtij aplikacioni.

E nënshkruar në këtë datë

/ /

Nënshkrimi i përfaqësuesit të Aplikuesit 1

Emri i plotë:

Nënshkrimi i përfaqësuesit të Aplikuesit 2

Emri i plotë:

Unë/Ne, nëpërmjet kësaj paraqesim pagesën në lidhje me këtë kërkesë për aplikimin për licencë të ndërmjetësimit në sigurime, sipas Skemës së Tarifave të BQK-së që gjendet e publikuar në ueb-faqen zyrtare: www.bqk-kos.org, siç kërkohet në nenin 130 të Ligjit për sigurimet.

Shuma e paguar: €

Nr. i transferit:

Data e pagesës:

E paguar nga:

Nënshkrimi:

(Emrat e plotë)



SHTOJÇ
REPUBLIKËS SË KOSOVËS
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO
ZHVENDOSJEN E ZYRAVE
TË NDËRMJETËSUESVE NË
SIGURIME BREND
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2 SHËNIME UDHËZUESE

Ky formular shërben si aplikacion për hapjen dhe zhvendosjen e zyrave të ndërmjetësuesve në sigurime brenda Republikës së Kosovës, i cili mund të shkarkohet edhe nga ueb faqja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Gjatë plotësimit, ju nuk duhet të ndryshoni apo fshini ndonjë pyetje. Nëse plotësimi i këtij formulari nuk është i mundur përmes kompjuterit, atëherë të njëjtin mund ta shtypni dhe plotësoni me SHKRONJA TË MËDHA DHE NGJYRË TË KALTËRT. Nëse se ndonjëra nga kërkesat e këtij formulari nuk aplikohet në rastin tuaj shkruaj N/A.

Ky formular i aplikimit duhet të plotësohet në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Personeli i Departamentit për Licencim dhe Standardizim është në dispozicion për konsultime në drejtim të përgatitjes së këtij formulari të aplikimit. BQK-ja mund të kërkojë, përmes personelit të Departamentit për Licencim dhe Standardizim, çfarëdo dokumentacioni apo sqarimi që konsiderohet i nevojshëm për vlerësimin e BQK-së.

Nëse ndonjë aplikacion është i pakompletuar, BQK nuk do ta shqyrtoj atë. Gjithashtu nëse ndonjë aplikacion nuk i shpalos të gjitha informacionet që mund të ndikojnë në vlerësimin e BQK-së, kjo në minimum mund të rezultojë në minimum në vonesa të konsiderueshme në procedim. BQK-ja nuk merr përgjegjësi për çfarëdo humbje që i shkaktohet aplikuesit nga ndonjë vonesë.

Informacion për Identifikimin e Ndërmjetësuesit	
Emri i ndërmjetësuesit	
Lokacioni i zyrës qendrore	
Adresa	
Kodi Postar	
Qyteti	
2.1 Informacion për Identifikimin e Aplikacionit (vendosni një shenjë mbi kutinë e duhur)	
